



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I JASHTËM I VLERËSIMIT

Nr.32/183 Prot

Tiranë, më 28/02/2020

V E N D I M

Nr.12. datë 14.02.2020

Trupa e vlerësimit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, e përbërë nga:

KRYESUES: Ledian RUSTA
RELATORE: Sonila KADAREJA
ANËTARË: Luljeta QOKU

asistuar nga anëtarët e Sekretariatit Teknik, Suela Pashaj, Erlisa Shkodrani, më datë 14/02/2020, ora 10:00, në Tiranë, në Pallatin e Koncerteve, (*Ish –Pallati i Kongreseve*), salla B, kati 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore që i përket:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT: **Bujar Zenel Ahmeti**, i datëlindjes 20/12/1968, lindur ne Tepelenë dhe banues në Bulevardi “Bajram Curri” Tiranë, me funksion *Drejtor i Drejtorisë së Forcave të Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit*, përfaqësuar me deklaram nga Avokat Kozma Janka me Nr. 760 Licenca, NUIS K436623K, Avokat pranë Dhomës Avokatisë Tiranë.

OBJEKTI: **Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit**

BAZA LIGJORE: **Ligji Nr.12/2018** “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjejt e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” (I ndryshuar);
Ligji Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administratite të Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar);
Ligji Nr.49/2012 “Per Organizimin dhe Funkionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (i ndryshuar);
Rregullorja e Brendshme e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit,
Rregullorja për Miratimin e Hapave Proceduralë të Unifikuar për Procesin e Vlerësimit.

TRUPA E VLERËSIMIT TË KOMISIONIT TË JASHTËM TË VLERËSIMIT

pasi dëgjoi gjetjet bazuar në arsyetimin ligjor si dhe rekomandimin e relatores së çështjes Sonila Kadareja, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Bujar Zenel Ahmeti, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të Ligjit 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit (këtu e në vijim Komisioni) është organi kompetent që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*” (i ndryshuar) (këtu e në vijim ligji i vlerësimit 12/2018 (i ndryshuar)

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Sipas përcaktimeve të neneve 2, 3 pika “17” dhe “18” dhe neneve 4 e 6 të Ligjit nr. 12/2018 “*Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*” (i ndryshuar), shtetasi Bujar Zenel Ahmeti, është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, për arsye të funksionit të tij “*Drejtor i Drejtorisë së Forcave të Posaçme Operacionale*” në *Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit*”.

Në kohën e dorëzimit të deklaratës “*vetting*” subjekti Bujar Ahmeti mbante postin aktual.

Subjekti i vlerësimit, Bujar Ahmeti, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 3.6.2019, nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit në përputhje me Rregulloren “*Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit*”.

Trupa e Komisionit, në veprimet e saj proceduriale, menjëherë pas hedhjes së shortit dhe marrjes së dokumentacionit të depozituar nga subjekti në zbatim të Ligjit 12/2018, konstatoi se subjekti ka paraqitur konform ligjit dhe në afatin e përcaktuar në këtë ligj datë 3/5/2018) të tre deklaratat që parashikon ligji 12/2018, për kontrollin e pasurisë, kontrollin e figurës si dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale. Formulari i pasurisë ka nr Indeksi Nr.192, viti 2018.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga Ledian Rusta, (Kryesues) Sonila Kadareja (Relatore-Anëtar) dhe Luljeta Qoku (Anëtar).

Trupa e vlerësimit në përputhje me Ligjin e vlerësimit 12/2018 (i ndryshuar) si edhe në bazë të Rregullores së Brendshme të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit (*miratuar me Vendimin nr.17 datë 31.5.2019 “Për*

Hapat Proceduralë të Unifikuar gjatë Vlerësimit të Subjekteve nga Trupa e Vlerësimit”), me Vendimin nr.1, datë 18.6.2019, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Bujar Zenel Ahmeti.

1. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 24.6.2019 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
2. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Komision në datën 26/6/2019 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
3. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018 (i ndryshuar), duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
4. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit të vlerësimit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - a) *vlerësimin e pasurisë;*
 - b) *kontrollin e figurës;*
 - c) *vlerësimin e aftësive profesionale.*
5. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
6. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në Ligjin e vlerësimit 12/2018 (i ndryshuar), Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar), duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Ministrinë e Brendshme që janë:
 - *Deklarata e Pasurisë,*
 - *Deklarata për Kontrollin e Figurës dhe*
 - *Formulari i Vetëvlerësimit Profesional;*
 - *Provat shkresore / dokumente të administruara nga institucionet/orgaanet publike dhe private në përputhje Ligjin nr.12/2018 (i ndryshuar).*
 - *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit si edhe, ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gadishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*
7. Trupa e vlerësimit në datën 6.2.2020 pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë ndjekur të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Bujar Ahmeti, me Vendimin nr.2 datë 6.2.2020, vendosi;

- ❖ Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Bujar Zenel Ahmeti , me funksion Drejtor në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
 - ❖ Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - ✓ *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - ✓ *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
 - ✓ *Të drejtën e subjektit për t'u njohur me dosjen, zyren/vendin ku mund të njihet dosja, si dhe të marrë një kopje të tyre, me përjashtim kur subjektit i kufizohet kjo e drejte në rastet e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror”. Dosja i vihet në dispozicion subjektit sipas neneve 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke respektuar të drejtat e palëve sipas neneve 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative.*
 - ✓ *Të drejtën e subjektit për të kërkuar thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e çdo prove mbështetëse. Kjo kërkesë duhet të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme për identifikimin dhe kontaktimin e dëshmitarit, si dhe të dhënat mbi thelbin e informacionit të pritshëm.*
 - ✓ *Afatin brenda të cilit duhet të bëjë kërkesën me shkrim për njohjen me dosjen dhe të paraqesë prova/shpjegime me shkrim apo të bëjë kërkesa në përputhje me pikat “d” dhe “e” të pikës 3 të Rregullores së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit për hapat proceduralë të unifikuar gjatë vlerësimit të subjekteve nga Trupa e Vlerësimit.*
8. Hetimi administrativ përfshiu edhe “personat e lidhur” apo “persona të tjerë të lidhur” në kuptim të pikës 11 të nenit 3 dhe neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe pika 1 e nenit 34 e Ligjit të Vlerësimit nr.12/2018 (i ndryshuar).
9. Në datën 12/2/2020, trupa e vlerësimit nëpërmjet kryesuesit të seancës, njoftoi subjektin e vlerësimit për mbajtjen e seancës dëgjimore në datën 14 Shkurt 2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, (*Ish –Pallati i Kongreseve*), salla B, kati 0, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit 12/2018 (i ndryshuar).

II. SEANCA DËGJIMORE

-)] Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Bujar Ahmeti, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative.
-)] Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të përfaqësohej me deklaram në seancën dëgjimore me Avokat Kozma Janka me Nr.760 Licenca, regjistruar me NUIS(NIPIT) K436623K, Avokat pranë Dhomës Avokatisë Tiranë.
-)] Gjatë seancës dëgjimore, pas fjalës së relatorit, subjekti i vlerësimit parashtrori disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij (*të regjistruar në materialin audio në seancë dëgjimore*).
-)] Në fund të seancës dëgjimore datë 14.2.2020, subjekti i vlerësimit Bujar Ahmeti si dhe Avokati i tij, kërkuan konfirmimin në detyrë. Po në këtë datë Trupa e vlerësimit shpalli vendimin për subjektin e vlerësimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

-) Subjekti i vlerësimi Bujar Ahmeti ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit të Vlerësimit 12/2018(i ndryshuar);
-) Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave edhe dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimet administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara nga relatorja, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim i kërkuar nga ana e relatores.

IV – A) VLERËSIMI I PASURISË

- ✚ Vlerësimi i Pasurisë është kryer bazuar në dispozitat që normon neni 31 -34 i Ligjit të Vlerësimit 12/2018, (i ndryshuar).
- ✚ Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësin dhe për personat e lidhur me të.
- ✚ Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të neneve 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit, bazuar në të cilin trupa e vlerësimit zhvillon një procedurë kontrolli, në përputhje me Ligjin e Vlerësimit (12/2018), Ligjin për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të Personave të Zgjedhur dhe Nëpunësve të caktuar Publikë, Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike, Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, si dhe Kodin e Procedurave Administrative.
- ✚ Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer veprimet verifikuese, ku Komisioni me anë të korrespondencës të rregjistruar me numër 32, ka kërkuar të dhëna në institucionet bankare në vend, institucionet financiare dhe jofinanciare, Kadastër, ZRPP rajonale, ALUIZNI, DPSHTRR, QKB, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, DPPP, ISSH, Regjistrin Noterial pranë Ministrisë së Drejtësisë, OSHË, Ujësjellës Kanalizime, kompanitë e komunikimit telefoniks fix etj. Gjithashtu Komisioni ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e vet subjektit për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar si dhe gjatë pyetësorit sqarime të tjera financiare për burim të ardhurash apo mbulim shpenzimesh/huash për personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur.
- ✚ Hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë edhe në deklaratat periodike të mëparshme që ka depozituar subjekti në ILDKPKI për shkak të qënies së tij për disa vite jo në mënyrë të vazhdueshme në pozicione që bëhen subjekt deklarimi sipas Ligjit 9049/2003 (i ndryshuar), për deklarimin dhe kontrollin e pasurive. Trupa vlerësuese është treguar e kujdesshme lidhur me marrjen e këtyre deklarimeve dhe vlerësimin e tyre në natyrën e tyre rrethanore në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore sipas ligjit për deklarimin e pasurisë dhe të raportit të rëndësisë që mbartin ato në vetvete krahasuar me deklaratën e pasurisë Vetting 2018, në nivel krahasimor, duke qenë se elementët për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin dhe personat e lidhur me të,

gjenden të shprehur si në deklaratat periodike ashtu dhe atë veting. KJV, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë, i ka vlerësuar këto deklarata së bashku me provat e tjera në tërësi dhe harmoni me të gjitha rrethanat e çështjes.

A) I. DEKLARATA E PASURISË

1. Në zbatim të nenit 32 të Ligjit nr. 12/2018, subjekti i vlerësimit i nënshtrohet procesit të vlerësimit kalimtar për periudhën e vlerësimit të deklaratës së pasurisë nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.
Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr 12/2018 si vijon;
2. **Apartament banimi , sip 91m²**, ndodhur në Tiranë, zona kadastrale 8260, me adrese Rruga “Njazi Demi”, pallati 2/1, kati 2, sipas vërtetimit hipotekor ***, datë 7.10.2005. Vlera 1,900,000(një milion e nëntëqind mijë) lek. Burimi i krijimit: dhuratë nga vëllai i subjektit “P.A” në shumën 1,000,000(një milion) lek. Pjesa tjetër 900,000(nëntëqind mijë) lek kursime familjare.
3. **Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit për vërtetimin e faktit administroi;**
 - a) deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur¹
 - b) dokumentacioni i administruar nga Komisioni²
 - c) dokumentacioni i administruar nga deklaratimet e subjektit dhënë Komisionit si përgjigje të pyetjeve të dërguara në rrugë zyrtare.

➤ **Hetimi i Komisionit :**

- Komisioni kërkoi informacion ASHK, Regjistrin Noterial, OSHË, Ujësjellës Kanalizime, rrjetet e telekomunikacionit, ILDKPKI si dhe ju drejtua vet subjektit.
 - Nga përgjigjet e administruara dhe të analizua nga trupa e Komisionit, rezultoi se:
4. **Nga përgjigjia e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Nr. ****Prot,** datë 21/08/2019 e KJV, dërguar nga Drejtoria Vendore Tirana Jug, vërtetohet se në emër të Bujar Zenel Ahmeti rezulton pasuria e deklaruar nga subjekti, përputhet prona e deklaruar sipas të dhënave të rregjistruara në këtë Agjensi:
 5. **Nga rregjistri noterial** vihet në dispozicion Kontrata e Shitblerjes, nr ***kol. me nr *** rep, datë 06/10/2005, nënshkruar nga Shitësi: E. H., dhe Blerësi : Bujar Zenel Ahmeti me objekt: Shitje Pasuri e Palujtëshme Apartament kundrejt çmimit 1,900,000(një milion e nëntë qindë mijë) leke.
- ✓ **Konfirmohet kontrata e shitblerjes midis subjektit në cilësinë e blerësit dhe të palës shitëse.**

¹ Kontratë shitblerje me nr ***kol. me nr *** rep. datë 06.10.2005; Librezë e Ujësjellës Kanalizime Tiranë (fotokopje e pagesave për vitin 2017) me nr ***; Librezë e OSHË Tiranë (fotokopje e pagesave për vitin 2017) me nr***; Vërtetim nga Dokumenti Hipotekor, e lëshuar me nr *** datë 07/10/2005;

² Shkresa “Kthim Përgjigje ASHK Tirana Jug” me nr. ***Prot., dt.21/08/2019; Shkresa “Kthim Përgjigje UKT” me nr. ***prot., dt.04/10/2019, Shkresa “Kthim Përgjigje OSHË” me nr. ***prot.dt.07/10/2019; “PROKURE E POSACME” me nr ***kol. me nr *** rep.dt. 20/06/1999; “KONTRATE-SHITJE” me nr ***kol. me nr *** rep.dt.28/06/1999;” DEKLARATE NOTERIALE” me nr ***kol. me nr *** rep.dt.14/04/2008

6. **Nga përgjigjia e OSHEE Nr. ****prot.**, datë 07/10/2019, vërtetohet se subjekti ka lidhur kontratën e energjisë elektrike në emër të tij dhe sipas referencave dhe adrestarit të kësaj kontrate, përputhet kjo pronë me deklarinimin.
7. **Nga përgjigjia e Ujësjetës Kanalizime Nr. ****prot**, datë 04/10/2019 rezultoi nga verifikimet Kontrata me nr “X” regjistruar në SMI (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit) në emër të Bujar mbiemër “Konati”. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit duke konstatuar se identiteti i klientit të regjistruar në UKT në elementin e mbiemrit ndryshon, verifikoi edhe një herë të dhënat e gjendjes civile, të dhënat e kontrates, numrit unik të saj, nga ku rezultoi se bëhet fjalë për të njëjtin klient që përkon me subjektin.
- ✓ **Sa më lart, vërtetohet se subjekti ka lidhur kontratën e ujit në emër të tij dhe sipas referencave dhe adrestarit të kësaj kontrate, përputhet kjo pronë me deklarinimin.**
8. Nga kompanitë private të komunikimit tokësor dhe elektronik, rezultoi se nuk ka ndonjë kontratë abonimi tjetër përveç asaj që ka deklaruar dhe që pas vërtetimeve përkon me asetin deklarues (apartamentin e banimit).
9. **Deklarimi në ILDKPKI:** Në deklaratën periodike të vitit 2006 për vitin 2005, është deklaruar aseti i blerë në vitin 2005 në vlerën 1.900.000 (një milion e nentë qindë mijë) lek.

Komisioni konkludoi se përputhet deklarimi Vetting me atë të ILDKPKI për ekzistencën e këtij aseti.

A) II. BURIMI I TË ARDHURAVE PËR BLERJEN E SHITËPISË:

➤ Hetimi i Komisionit :

Trupa kërkoi informacion nga Regjistri Noterial si dhe i drejtoi pyetje subjektit.

10. Nga rregjistri noterial u administrua “Kontratë Shitje” me nr ***kol. me nr *** rep.dt.28/06/1999 (në vlerën 1.000.000 lek të cilën subjekti e ka përfituar dhuratë pas shitjes së një garzionere prone e cila rezultonte në pronësi të vëllait të tij). “Prokurë e Posaçme” me nr ***kol. me nr *** rep.dt. 20/06/1999 ku vëllai P. Ahmeti, ku autorizon vëllain e tij Bujar Ahmeti të drejtën për të shitur garsioneren, si dhe më tej disponohen ”Deklarate Noteriale” me nr ***kol. me nr *** rep.dt.14/04/2008 për dhurimin e vlerës 1.000.000 (një milion) lek të përftuara nga shitja e garsioneres në pronësi të vëllait dhe bashkëshortes së vëllait të subjektit.

Në kuptim të Ligjit 12/2018, neni 3 pika 14, shtetasi P.A. dhe bashkëshortja e tij L.A., konsiderohen persona të tjerë të lidhur.

11. **Në pyetjet drejtuar subjektit përmes postës elektronike të datës 2.10.2019**, lidhur me vitin e dhurimit së shumës 1.000.000 (një milion) lek, mënyrën e kalimit të parave, “cash” apo kalim në llogari bankare, përmes kujt akti ligjor kalimi/dhurimi është kryer, ku ka jetuar vëllai pas shitjes së kësaj garzionere që kishte në pronësi, adresën e banimit të vëllait si dhe adresën e banimit të

subjektit nga viti 1999-2005, Subjekti është përgjigjur me anë të shkresës Nr. *** **Prot., datë 07/10/2019 ku ka bërë sqarimet përkatëse³ si dhe dëguar dokumentacion provues⁴:**

12. Nga rregjistri noterial u administruan: pervec kontratave të blerjes fillestare te apartamentit nga vëllai dhe kontrata e shitjes së tij, Prokurave të Posaçme që dy bashkëshortët L.Ahmeti dhe P. Ahmeti emërojnë përfaqësues të posaçëm Bujar Ahmeti të kryejë veprimet për shitjen e apartamentit të banimit garzionerë pronë e P.Ahmetit e cila ndodhet në Tiranë.

13. Si dhe Shkresa Kthim Pergjigje e noterit V.F. Nr. ***Prot datë 09/08/2019⁵ në KJV, ku është përcjellë dokumenti:

-Deklaratë Noteriale (Për dhurim Vlerash Financiare), Nr. ***, dt.14/04/2018⁶, deklaruar nga shtetasit: P.Ahmeti, dhe bashkëshortja e tij L. Ahmeti , të cilët kanë deklaruar se *“Me vullnet të lirë e të plotë më datë 28/06/1999 kanë shitur një Garzonierë përkundrejt çmimit 1,000,000(një milion) lek. Ky fakt provohet me Kontratën e Shitjes Nr. ***Rep., Nr. ***Kol, datë 28/06/1999⁷, redaktuar përpara noterit. Deklaruesit pohojnë se pas shitjes së kësaj pasurie vlerën monetare prej 1,000,000(një milion)lek ja kanë dhuruar z. Bujar Ahmeti vëllait të deklaruesit. Dhurimi është bërë për shënjë dashurie mirënjohje dhe respekti vllazëror.*

- **Sa më lart, Komisioni konstaton se vlera prej 1.000.000 (një milion)lek të përfutuar nga shitja e garzioneres së vëllait të subjektit dhe dhuruar subjektit, është burim i ligjshëm dhe i vërtetuar. Subjekti ka bërë deklarim të saktë dhe ka mbulim të justifikuar të ardhurash për shumën prej 1.000.000 (një milion) lek të dhuruar nga vëllai si pasojë e shitjes së apartamentit të tij dhe përfutuar nga subjekti me qëllim mbulimin e shumës tërësore prej 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë)lek për blerjen e apartamentit të tij në vitin 2005.**

³ Duke ju referuar Kontratës së Shitjes Nr.3677 rep, Nr.433 kol., datë 28/06/1999, shitja e garzioneres është bërë nga ana ime në bazë të prokurës së posaçme me Nr.487741, të lënë nga vëllai im P. A. të përmendur në kontratën e shitjes. Lekët e dhuruara që ju kam deklaruar më parë i kam marrë në vitin 1999 që në momentin e shitjes së garzioneres së vëllait sipas prokurës së posaçme.

Paratë më janë dhënë “Cash” nga blerësi i garzioneres që në momentin e shitjes së shtëpisë.

Vëllai im P.A. në vitin 1999 ka qënë duke jetuar e punuar familjarisht në Greqi.

Në vitin 1997 vëllai im P. A. ka blerë shtëpi në Mbrostar Ura Fier sipas Notës së Traskriptimit lëshuar nga Hipoteka me nr.1336 regjistri, blerë në shumën 1.300,000(një milion e treqind mijë) lek. (Bashkëlidhur kopje e notës transkriptimit). Shtëpia e blerë nga vëllai im P.A. është blerë me kontribut financiar të vetat dhe të babait tonë (i cili kishte shitur shtëpinë e vjetër në Rabije-Tepelenë dhe gjithë bagetinë) si dhe të vëllait tim të vogël P. A. i cili punonte në Greqi.

Shuma prej 1,000,000(një milion)lek që une kam dhuratë nga vëllai P. A., e kam marrë që në vitin 1999 me shitjen e shtëpisë (garzionerë) të vëllait tim P.A., i cili më kishte dhënë të drejtë shitje me prokurë të posaçme. Kjo sasi lekësh e marrë nga shtëpia e shitur e vëllait më është dhuruar mua që nga momenti i shitjes së shtëpisë meqënëse unë duke qënë me punë në Tiranë kam banuar aty për rreth dy vjet. Kjo sipas traditës së zonës të ndarjes së të mirave nga ana e babit pas ndarjes sonë familjare. Kjo dhuratë m'u bë nga ata, pasi babai dhe vëllezërit kishin blerë një shtëpi tjetër në vitin 1997 në Mbrostar Ura të Qytetit të Fierit ku banojnë dhe aktualisht.

Në lidhje me të ardhurat e vëllait P. A. dhe bashkëshortes L.A. sqarojë se vëllai ka punuar dhe jetuar në Greqi që nga viti 1993 deri në vitin 2010, por me vizë rezulon që nga viti 1997 (bashkëlidhur ka paraqitur edhe pasaportën).

Bashkëshortja L. A. nuk ka punuar sepse ka mbajtur fëmijët dhe prinderit e mi sepse babi im ka qënë invalid luftë.

⁴ Kontratën e shitjes së garzioneres nga Bujar Ahmeti ne emer te vëllait të tij P.A , me prokurë; Prokurë e posaçme për shitjen e shtëpisë nga vëllia Bujar Ahmeti; Plan vendosje e banesës grazionerë, planimetria e Apartamentit; Kontratë e origjinës kur është blerë prona për herë të parë (1996) në vlerë 550.000(pesë qindë e pesë dhjetë mijë) lek nga vëllai P. A.; Prokurë e posaçme nga L.Z (A) gruaja e vëllait, në cilësnë e bashkëpronares në zotërim të garzioneres, e cila dhe ajo autorizon me prokurë Bujar Ahmeti që të kryejë veprime me palë të treta; Vërtetim pronësi në Zonën Kadastrale 8180 ; Harta regjuese e pasurisë; -Certifikatë familjare , në bazë të rregjistrit themeltar të vitit 1974, Mbrostar Ura 76/46 që vërteton përbërjen familjare nga data 14.10.2002-11.6.2005;

-Certifikatë familjare, në bazë të rregjistrit kombëtar të gjëndjes civile të vitit 2010, që vërteton përbërjen familjare nga data 12.7.2018; -Certifikatë familjare në bazë të rregjistrit kombëtar të gjëndjes cvivile të vitit 2010, që vërteton të dhënat e përbërjes familjare, për vëllain P. A., i ndarë nga trungu familjar në datë 13.7.2018; -Certifikatë vdekje të babait të subjektit, njësia administrative Ura Mbrostar, ku vërteton se data e vdekjes së të atit është 12.6.2005;Pasaporte e vëllait me leje qëndrimi dhe punësimi në shtetin grek që prej vitit 1997; Notë transkriptimi nr. 1336, Regj , dt. 21.10.1998, marrë nga hipoteka Fier, me anë të së cilës vërtetohet se vëllai P. A., në datë 5.12.1997, është bërë pronar i vetëm dhe i ligjshëm i një shtëpie banimi një katëshe të ndodhur në Mbrostar Ura Fier, në vlerën e shtëpisë 1.300.000(një milion e treqind mijë) lek.

⁵ Kthim Pergjigje e noterit V.F. Nr. ***Prot datë 09/08/2019

⁶ Deklaratë Noteriale (Për dhurim Vlerash Financiare), Nr. ***, dt.14/04/2018

⁷ Kontratën e Shitjes Nr. ***Rep., Nr. ***Kol, datë 28/06/1999

14. Për pjesën e mbetur të shumës prej 900.000(nëntëqind mijë) lek nga 1.900.000(një milion e nëntë qindë mijë) lek në total që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit siç deklaroi dhe subjekti, janë nga kursimet ndër vite nga pagat e bashkëshortëve.

Trupa kreu analizën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit dhe familjes së tij deri në vitin 2005 nga ku rezultoi se :

Shpenzimet për frymë sipas INSTAT		Për frymë	Konsumi për familje	Total të ardhurat	Diference të ardhura minus shpenzime për çdo vit	Vitet	Progresive fitimi për çdo vit deri në 2005
viti	1994		51.418	64.273	12.855	1994	
viti	1995		181.241	226.551	45.310	1995	58.165
viti	1996		280.061	350.076	70.015	1996	128.180
viti	1997	5.000	180.000	433.713	253.713	1997	381.893
viti	1998	5.000	240.000	624.193	384.193	1998	766.086
viti	1999	5.000	240.000	1.858.429	1.618.429	1999	2.384.515
viti	2000	108.000	432.000	888.236	456.236	2000	2.840.751
viti	2001	108.000	432.000	1.023.593	591.593	2001	3.432.344
viti	2002	93.864	375.456	1.453.409	1.077.953	2002	4.510.297
viti	2003	93.864	375.456	1.308.141	932.685	2003	5.442.982
viti	2004	93.864	422.388	1.786.866	1.364.478	2004	6.807.460
viti	2005/6 mujori I		273.893	717.529	443.637	2005	7.251.097
viti	2005/ 6mujori II	109.557	273.893	668.865	- 3.988.828	2005	3.262.269

15. Subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për vlerën monetare prej 900.000 (nëntëqind mijë)lek si pjesë e totalit për të përballuar blerjen e apartamentit.

Në përfundim të hetimit Komisioni arrin në konkluzionin se për këtë aset:

- ❖ *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e institucioneve përkatëse.*
- ❖ *Subjekti ka burime financiare të ligjshme për krijimin e këtij asemi.*

A) III. PASURI TË LUAJTSHME:

16. *Subjekti ka deklaruar se ka disponuar:*

Automjet me targë TR 1770 blerë në vitin 2010 në shumën 500.000(pesëqind mijë) lek, burimi nga të ardhurat familjare. Ky automjet është shitur në vitin 2012, në shumën 250.000(dyqind e pesëdhjetë mijë) lek.

➤ Hetimi i Komisionit :

17. Nga praktika e DPSHTRR konfirmohet blerja e automjetit të lartcitur në vitin 2010 në vlerën 500.000(pesëqind mijë) lek (me Kontratën e Blerjes para noterit me nr. ***, dt.6/7/2010) si dhe shitja e tij në vitin 2012 në vlerën 250.000(dyqind e pesëdhjetë mijë) lek (Kontrata e Shitjes nr.*** date 26/03/2012).

18. Burimi për blerjen e autoveturës në datë 6/7/2010:

Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të konstatohet se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme në vitin 2010 për të kryer blerjen e automjetit (*tabela shtojca 1, pasqyrim i gjendjes financiare deri ne vitin 2010, të ardhurat nga paga dhe teprica e kursimeve e mbartur pas çdo viti*).

- 19. Në deklaratën Vetting 2018, subjekti ka deklaruar Depozitë Bankare me afat 1(një) vjeçar në një Bankë të nivelit të dytë (Tirana Bank) në shumën 1.000.000(një milion) lek. Pjesa në % : 100%.
Burimi i krijimit të kësaj shume (nga të ardhurat familjare)**

➤ **Hetimi i Komisionit :**

Nga vërtetimi dhe statement bankar, i Bankës së Nivelit të Dytë *(Tirana Bank), rezulton se subjekti ka çelur llogari depozite me interes në datën 14 Shkurt 2016 në shumën 1.000.000(një milion) lek.

Nga verifikimi i llogarisë rrjedhëse të pagave dhe gjendjet e mbartura në vite pranë kësaj banke, rezulton se kjo shumë është rrjedhojë e akumulimit të vlerave nga të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet dhe kjo depozitë ka rezultuar po në këtë vlerë përfshirë interesat bankare në datën 3.5.2018.

Më tej, Komisioni, ka verifikuar veprimet bankare ndër vite, përkatësisht në dy llogaritë bankare të nivelit të dytë në emër të subjektit:

-Tirana Bank, çelur llogari rrjedhëse në vitin 2011 dhe

-Raiffeisen Bank çelur në vitin 2005.

Rezulton se subjekti ka përdorur llogarinë Raiffeisen deri në vitin 2011, kohë kur ka çelur llogarinë rrjedhëse në Tirana Bank. Që prej këtij viti e në vijim, subjekti ka llogari rrjedhëse vetëm në Tirana Bank.

- 10 Shkurt 2014 shuma 750.000(shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lek çelje depozite nga llogaria rrjedhëse

- 7 Maras 2014 shuma 450.000(katërqindë e pesëdhjetë mijë) lek “ “ “

- Maj 2014 shuma 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lek “ “ “

- Shkurt 2016 në shumën 1.000.000 (një milion) lek “ “ “

- Nga vërtetimi bankar rezulton Llogari rrjedhëse në Bankë të nivelit të dytë (Tirana Bank) deri në datën dt.28.4.2018, në shumën 244.042(dyqind e dyzetë e katër mijë e dyzetë e dy) lek.

Burimi i krijimit : Të ardhura nga pagat.

- ❖ **Komisioni ka konstauar se deri në fund të vitit 2017 dhe fillim 2018, rezulton se subjekti ka patur tepricë të ardhurash të përfituara nga paga +shpërblime, kjo e verifikuar nga statement bankar, mbi gjendjen në llogarinë rrjedhëse në vlerën e lartcitur.**

20. Gjithashtu, Komisioni verifikoi edhe deklaratimet në ILDKPKI të subjektit lidhur me gjendjet bankare në vite. Në deklaratën periodike të subjektit në ILDKPKI të vitit 2006, subjekti ka deklaruar se ka depozitë në vlerën 700.000 (shtatëqind mijë) lek, në zotërim 100%. Komisioni ka verifikuar statement bankar në Raiffeisen Bank në të cilën rezulton se në datën 9.1.2006 ka gjëndje në shumën prej 700.000(shtatëqind mijë) lek.

❖ **Komisioni konkludon për sa më sipër, se subjekti ka bërë deklaram të saktë në zbatim të detyrimeve sipas ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar ,**

A) IV. DEKLARIMI I PASURIVE NGA PERSONI I LIDHUR (BASHKËSHORTJA)

21. Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në deklaratën Vetting 2018 se disponon pasuri veçmas bashkëshortit .

Kontratë sipërmarrje Nr. ***datë 22.07.2005, ndërmjet E. C. dhe porositesit Julinda Ahmeti, vlera totale sipas kontratës për apartamentin është 37 200 euro. Janë paguar 20 000 euro me datë 22.07.2005, detyrim i papaguar 17 200 euro⁸.

➤ Hetimi i Komisionit :

Trupa kërkoi aktet noteriale, nga ku u vu në dispozicion kontrata e sipërmarrjes dhe dokumentet e tjerë shoqërues.

22. Nga ASHK -Shkresa “Kthim përgjigje” nr.***prot., datë 05/08/2019⁹, dërguar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, vërtetohet se:

Nga verifikimi në bazë të dixhitalizimit të të dhënave të vetdeklarimeve, subjekti i përmendur rezulton aplikues i procesit të legalizimit:

Julinda Elmas Ahmeti (SR-866 date 19/05/2017, ndërtim pa leje 2010 Sarandë).

23. Referuar pyetësorit dt.2/10/2019 dërguar përmes postës elektronike subjekti ka depozituar pranë Komisionit përgjigje me nr. .***prot., datë 07/10/2019, në lidhje me të dhënë më sipër¹⁰.

a) Komisioni konstaton se ka problematikë lidhur me mosrespektimin e kontratës së sipërmarrjes nga ana e sipërmarrësit ku përcaktohet parashikimi kontraktor me penalitete në rast të veprimeve moslikuidim dhe kthim të shumës prej 18.000 eurosh nga 20.000 euro brenda dy viteve në rast se nuk dorëzohet apartamenti në kohë.

⁸ Kontrate Sipërmarrje , nr. ***rep. Nr. ***, dt 22 Korrik 2005; Libreza e Furnizimit me energji elektrike OSHË Nr***; Libreza e furnizimit me uje UKT nr. *** në emër të konsumatorit Julinda Ahmeti.

⁹ Shkresa “Kthim përgjigje” nr.***prot., datë 05/08/2019 nga ASHK

¹⁰ Përgjigje pyetësorit, depozituar nr.***prot., datë 07/10/2019:

Shtëpia nuk është përfunduar sipas përshkrimit të kontratës së porosisë. Apartamenti është i bllokuar nga ana jonë por nuk është marrë në dorëzim përfundimisht , sepse nuk është përfunduar plotësisht si dhe rezulton I bllokuar gjithashtu nga Përmbartimi për llogari të banakve në të cilat ndërtuesi ka marrë kredi. Shuma prej 17200 Euro nuk është likuiduar ende sot pasi Ap nuk është marrë në dorëzim sic shpjeguar më lart, firma ndërtuese nuk ka plotësuar kushtet e kontratës së sipërmarrjes, ndërsa rezulton se Ap aktualisht është I rregjistruar në ZQRPP në emër të ndërtuesit E.C me zonë kadastrale 8641 nr.pasurie **** *. Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes dhe të ardhurat e mia, bashkëlidhur kopje të listë pagesave të ISSH. Çertifikatë vërtetim pronësie nr.***, në emër të E. C. si dhe Harta treguese e rregjistrimit dt.24.8.2017, listë pagesë e ISSH për pagat, vërtetimet e punës së subjektit dhe shpërblimet dhe taksë solidariteti.

- b) Komisioni gjatë hetimit, ka konstatuar se bashkëshortja e subjektit si person i lidhur në kuptim të ligjit 9049/2003 (i ndryshuar), të deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, kur disponon pasuri veçmas, bëhet subjekt deklarimi njësoj si subjekti i ligjit.
- c) Rezulton se në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në Prill 2018 të bashkëshortit të saj, në funksionin e drejtorit të Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale, e ka deklaruar këtë aset të paluajshëm ende të papërfunduar dhe marrë në dorëzim, të cilën e ka porositur vetëm në emër të saj.
- d) **Në këtë kontekst, Komisioni vëren se subjekti dhe personi i lidhur me të që pavarësisht se deklarohet se e ka lidhur vetëm në emër të saj kontratën e sipërmarrjes, duke qënë në cilësinë e bashkëshortëve të ligjshëm, në kuptim të Kodit Civil i cili referon të Kodi i Familjes “Regjimi pasuror martesor në bashkësi”, që normohet në nenet nga 73-77 të tij, përcakton se zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor dhe se bashkësia përbëhet nga: a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës; b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; etj .**

Sa më sipër dhe në vijim të interpretimit mbi rregjimin e përbashkët pasuror i cili rezulton për bashkëshortët B.Ahmeti dhe J.Ahmeti të cilët nuk rezultojnë me akte ligjore se ndodhen në kushtet e ekzistencës së pasurisë vetjake si një nga rastet e përjashtimit nga përfitimi i rregjimit pasuror të përbashkët (Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është: a) pasuria, e cila para lidhjes së martesës ishte në bashkëpronësi të bashkëshortit me persona të tjerë ose kundrejt së cilës ai ishte titullar i një të drejte reale përdorimi; apo b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë; etj .

Siç dhe deklarohet në deklaratën periodike të vitit 2018 dhe atë vetting 2018, si dhe nga përgjigjet e subjektit në shpjegimet e tij me shkrim, bashkëshortët nuk ndodhen në kushtet e lartcituara dhe si të tilla ky aset hyn në rregjimin e përbashkët pasuror dhe është pjesë e pandarë.

Vetëm në rast se do të kishte/ketë një marrëveshje paraprake të formalizuar me akt noterial që deklarohet se ky aset nuk do të jetë pjesë e pasurisë së përbashkët bashkëshortore, pra do të veçohet /ndahet duke mos u futur në rregjimin e përbashkët pasuror, atëherë ai mund të bëhet zotëruar 100% i tij. Kjo në kuptim të nenit 72 të Kodit të Familjes i cili përcakton se Bashkëshortët mund të bien dakord, në interes të familjes, për ta ndryshuar pjesërisht ose tërësisht rregjimin pasuror martesor vetëm pas kalimit të 2 vjetëve të zbatimit të tij. Për më tepër, që siç deklarohet edhe nga vet personi i lidhur (shuma prej 20.000 euro është dhënë nga kursimet e përbashkëta familjare) pra kontributorë në të janë të dy bashkëshortët dhe kursimet e tyre ndër vite nga të ardhurat nga puna.

24. Referuar pyetësorit dt.23 Janar 2020 dërguar përmes postës elektronike subjekti ka depozituar pranë Komisionit përgjigje me nr.*prot., datë 26/01/2020¹¹, në lidhje me deklarin e të dhënës ku dhe ka paraqitur sqarimet e tij**

¹¹ Siç ju kam deklaruar dhe më parë, dua tju sqaroj se:

Ligji 9049 datë 10.4.2003 ishte një risi në fushën e deklarimit të interesave private dhe i vuri zyrtarët deklarues përballë një detyrimi ligjor që nuk e kishin më parë. Deklarata për herë të parë e plotësuar në vitin 2003 dhe e dorëzuar në vitin 2004 por dhe deklaratat vijuese kanë pasaktësi në plotësimin e tyre, pasaktësi e cila ka ardhur si pasojë e mosnjohjes të mirë të ligjit por edhe nga mospasja e trajnimeve qoftë nga ana e ILDKP por edhe nga institucioimet përgjegjëse. Në trajnimet e zhvilluara (ato pak trajnime) nuk u kuptua qarte se përcaktimi i regjistruara në regjistrat publike duhet të deklaroheshin dhe ato të

- a) Në lidhje me konstatimet e mësipërme vlen të theksohet se Komisioni duhet të krijojë bindjen nëse subjekti, vërtet nuk ka patur për qëllim në ato vite kur ka qenë subjekt deklarimi, që të mosdeklaronte në mënyrë të qëllimshme këtë veprim juridik (lidhje kontrate sipërmarrje për porositje apartamenti) , për arsyet e shpjeguara nga vet ai.
- b) Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, si organ i ngritur në zbatim të ligjit të vlerësimiti kalimtar, ka për prioritet dhe bazë thelbësore plotësimin e drejtë dhe të saktë si dhe pasyrimin e çdo të dhene pasurore, financiare, detyrime e shpenzime që i rezultojnë subjektit që nga koha e marrjes së detyrës në strukturat e policisë së shtetit e deri në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit të Vlerësimit 12/2018 i ndryshuar kur i lind edhe detyrimi ligjor për të deklaruar pasuritë e tij të regjistruara ose jo në regjistrat publike, **duke vlerësuar çdo burim të ardhurash dhe konkretisht për këtë aset, burimin e tyre në atë vit, ekzistencën e ligjshme të tyre në atë periudhë (vit /muaj)për të paguar shumën paradhënie prej 20.000 euro në aktin/kontratën e sipërmarrjes për ndërtimin e apartamentit.**

Komisioni në seancën e datës 14 shkurt deklaroi se për sa konstatuar dhe shpjeguar më tej nga subjekti, do të mbante qëndrimin e tij në fund të vendimarrjes së tij për këtë aset, lidhur me shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me mosdeklarimin e këtij aseti në deklaratat që depozitohen periodikisht cdo vit në ILDKPKI , (mosdeklarime këto që evidentohen në deklaratat e pasurisë periodike vjetore për vitin 2005 , -2010) si dhe duke mbajtur në thelb të analizës së tij verifikimin për burimin e të ardhurave në atë vit, ekzistencës së ligjshme të tyre dhe verifikimit nëse subjekti ka patur burime të ligjshme dhe të mjaftueshme në atë periudhë (vit /muaj) për të paguar shumën paradhënie prej 20.000 euro në aktin/kontratën e sipërmarrjes për ndërtimin e apartamentit .

paregjistruara (si ne rastin tim konkret apartamenti i banimit eshte i paregjistruar nuk është nënshkruar kontrata perfundimtare e shit-blerjes por vetem ajo e sipërmarrjes), gjithashtu paqartësi kishte edhe për likuiditete cash ne banese. Eshte lehtesisht e verifikueshme se të ardhurat e mia familjare deri në vitin 2005 justifikojne krijimin e kursimeve të cilat kane sherbyer për pagesën e kryer per blerjen e apartamentit që ju citoni.Në momentin qe u riktheva përsëri si subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2018, njohurite për ligjin 9049 date 10.4.2003 dhe 9367 date 7.4.2005 ishin te plota dhe plotësimi i deklarates së interesave private "Para Fillimit te Detyres 2018", është bërë korekte dhe në përputhje me ligjin, duke deklaruar cdo gjë që disponoja në datën e fillimit të detyrës duke përfshirë si pasuritë e regjistruara në regjistrat publike ashtu dhe ato të paregjistruara.Dua të theksoj se pasaktesitë e konstatuara nga ana juaj në deklaratat e interesave private kanë ardhur vetem si pasojë e mosnjohjes se mirë te ligjit, mungesen e trajnimeve lidhur me plotësimin e tyre si nga ana e ILDKP dhe institucioneve pergjegjese.Deri ne momentin e lidhjes së kontrates së sipërmarrjes me nr 4428 rep dhe nr 955 Kol, datë 22.07.2005 ndërmjet bashkeshortes Sime Julinda Ahmeti dhe sipërmarrësit E. C. dhe derdhjen e shumës në vlerën për 20.000(njëzet mijë) euro, për këtë kontratë, sic ju kam sqaruar dhe më parë janë burim nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes nga pagat e deklaruar ndër vite. Të ardhurat e mia dhe bashkëshortes të ardhura nga pagat deri në datën e përpilimit te kontratës së sipërmarrjes kanë qënë afersisht 9.000.000(nëntë million) lek .Gjatë të gjithë karrierës time personale unë kam ushtruar funksione të ndryshme në Strukturat e Policisë së Shtetit , në reparte speciale si BRISK, RENE, FNSH, me trajtim special me ushqim pa pagesë, si dhe trajtimi me dietë për ditët e punës që kam marrë pjesë në operacione policore, të cilat kanë ndikuar ne menyrë të konsiderueshme në kursimet e familjes time. Gjithashtu në këto reparte kam marrë dhe shpërblime për detyra të veçanta nga fondit sekret i Ministrisë së Brendshme të cilat nuk janë pasqyruar për shkak të mos disponueshmerisë të dokumentacionit nga ana e institucionit.Në lidhje me detyrimin që rridhte nga kjo kontratë për pagesen e vlerës 17.200 euro, nëse do të zbatohet nga ana e sipërmarrësit të detyrimeve qe ai kishte, për një afat pagese prej 30 muajesh sipas kontratës kanë qënë mundësitë financiare nga ana jonë për t' u bërë pagesa nga të ardhurat e rrogës sime dhe të bashkëshortes pasi ka qënë një vlerë totale afërsisht 5.8000.000 (pesë milion e tetëqind mijë)lek. Kjo duket qartë dhe nga të ardhurat ndër vite si më poshtë:

*Viti 2006, 1.416.250 lek +88.000 lek Bashkeshortja;
 Viti 2007, 1.087.332 lek +337.146 lek Bashkeshortja;
 Viti 2008, 981.850 leke +383.875 lek Bashkeshortja;
 Viti 2009, 1.079.033 lek +417.555 lek Bashkeshortja ;*

Shuma prej 17.200 euro nuk është paguar nga ana jonë, pasi une kam dashur ta prish këtë kontratë sipërmarrje që në fillimet e saj, si dhe apartamenti nuk është marrë në dorëzim nga ana jonë, për arsye sepse firma ndërtuese nuk ka plotësuar kushtet e kontrates se sipërmarrjes, apartamenti aktualisht është i regjistruar në ZQRPP në emër të ndërtuesit E. C. me zona kadastrale 8641 nr pasurie 14\337+1-3,vol.40, faqe 163 dhe është bllokuar nga zyra e përmbarimit për Ilogari te bankave që ndërtuesi ka marrë kredi për ndërtimin e pallatit.

- c) Bazuar në përgjigjet e subjektit si gjatë fazës së hetimit administrativ ashtu edhe gjatë pyetjeve të ngritura nga Komisioni gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, i cili u shpreh se nuk ka patur njohuri të mjaftueshme ligjore për mënyrën si duhej të plotësohej deklarata e pasurisë në fillimet e hyrjes në fuqi të Ligjit 9049/2003 si dhe në vijim për shkak edhe të angazhimeve të tyre operacionale-policore në terren, trajnimet e strukturave përgjegjëse si në Drejtorinë e Policisë së Shtetit ashtu edhe nga vet ILDKPKI kanë qenë shumë të pakta dhe rrjedhimisht plotësimet e deklarimeve kanë patur mangësi në kuptimin dhe sqarimin ligjor të detyrimeve që mbarte ky ligj vit pa vit në plotësimin e deklaratave nga ana e subjekteve të këtij ligji.

➤ **Komisioni arriti në këtë konkluzion final :**

Duke marrë parasysh shpjegimet e subjektit lidhur me deklaratat në ILDKPKI, gabimet në plotësimin e tyre nga momenti i sapo hyrjes në fuqi të ligjit të deklaratimit të pasurisë për herë të parë në vitin 2003, kuptimit të tij nga viti në vit si dhe kërkesave dhe terminologjisë shpesh të pazberthyer mirë për subjektet e ligjit, dhe duke shprehur siç është thënë edhe në fillim të analizës, se Komisioni e konsideron deklaratën periodike për të krijuar bindjen e saj se si është raportuar një aset ndër vite, dhe/por mbi të gjitha a ka patur qëllim në vetvehte fshehja e një asemi, burimin e krijimit të asetit, ka orientur hetimin dhe verifikimin në rëndesine që mbart në teresi të procesit, fakti nëse subjekti i vlerësimit ka fshehur pasuri apo nuk i mbulon/justifikon ato. Rezulton se subjekti dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, e kanë deklaruar situacionin mbi porositjen e apartamentit në vitin 2005, në një nga deklaratat periodike të mevonshme për arsye siç ka justifikuar edhe vet subjekti në pyetësor dhe të cituara sa më lart si dhe gjithashtu në deklaratën vetting 2018.

Komisioni konsideron raportin që zë një mosdeklarim në kohë i një asemi dhe detyrimeve të shlyerjes së tij, situacionit të komplikuar të apartamentit të porositur i cili rezulton se edhe pas rreth 13 vitesh i porositur /prenotuar/ paguar gjysma e vlerës së tij, ende sot apartamenti është i papërfundur ligjrisht, fakt ky që ka shërbyer edhe për mospagimin e kështit të dytë në vlerën 17.200 euro, si dhe fakt që ka ndikuar në perceptimin e subjektit për moszotërimin apo mospasjen e një asemi që ende nuk ishte qartësisht dhe ligjrisht në pronësi të tij, e për pasojë të këtyre anomalive dhe zvarritjes jo për shkaqe të subjektit por të firmës ndërtuese, ai nuk i ka konsideruar si aset apo pronë mbi të cilën të kishte titull/rregjistrim ligjor në rregjistrin e hipotekës në emër të bashkëshortes në këtë rast.

Komisioni vlerëson se kjo mangësi në disa raportime periodike 2006-2010 kur subjekti ishte subjekt deklarimi (*sqarohet se në vitin 2010 e deri në vitin 2018 subjekti nuk ka qenë subjekt deklarimi në ILDKPKI*), nuk mund të pasjell *apriori* shkaqet e penalizimit të subjektit në atë masë të procesit të vlerësimit tërësor të KJV sipas dispozitave të nenit 62 të ligjit 12/2018 (i ndryshuar).

Pikërisht për shkaqet e lartcituara, Komisioni krijon bindjen se subjekti nuk ka patur për qëllim në ato vite kur ka qenë subjekt deklarimi, që të mosdeklaronte në mënyrë të qëllimshme këtë fakt të zotërimit nga ana e bashkëshortes, për shkallën e ulët të njohjes dhe kuptimit të ligjit, ndikimit të ulët të ndërgjyegjesimit për zbatimin korrekt të tij edhe nga autoritetet përgjegjëse që kishte ngritur çdo institucion për këtë qëllim.

Komisioni si organ i ngritur në zbatim të ligjit të vlerësimit kalimtar, ka për prioritet dhe bazë thelbësore plotësimin e drejtë dhe të saktë si dhe pasqyrimin e çdo të dhëne pasurore, financiare, detyrime e shpenzime që i rezultojnë subjektit që nga koha e marrjes së detyrës në strukturat e policisë së shtetit e deri në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit 12/2018 (i ndryshuar) kur i lind edhe detyrimi ligjor për të deklaruar pasuritë e tij të rregjistruara ose jo në rregjistrat publike.

Për peshën që këto deklarime apo mosdeklarime në disa prej deklaratave në ILDKPKI mbartin në raport me tërësinë e procesit të vlerësimit të subjektit, dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit, trupi vlerësues i çmon si fakt/rrethanë të pamjaftueshme për të passjellë, në rastin konkret, në mënyrë të vetme dhe të drejtëpërdrejtë aplikimin e pikës “c” të nenit 62, të Ligjit nr. 12/2018 (i ndryshuar), me pasojat e parashikuara prej tij. Këto Komisioni I cilëson si shkelje të Ligjit 9049/2003 por jo të Ligjit të Vlerësimit 12/2018 (i ndryshuar).

Siç dhe parashtruar më lart, subjekti dhe personi i lidhur me të, në këtë rast bashkeshortja e tij, e kanë deklaruar apartamentin dhe situacionin e tij që nga koha e porositjes deri me tani, *në një nga deklaratat periodike* si dhe deklaraten *vetting* si dhe me tej me dokumente shoqëruese dhe shpjegime te tjera në komunikimet me relatoren e trupes. Në këtë konstekt, Komisioni konstaton se subjekti dhe personi i lidhur me të që pavarësisht se deklaroi se e ka lidhur vetëm në emër të saj kontratën e sipërmarrjes, duke qënë se në cilësinë e bashkëshortëve të ligjshme, në kuptim të Kodit të Familjes dhe atij Civil, ky aset në të ardhmen do të jetë në rregjimin pasuror të përbashkët, edhe pse nuk është nënshkruar në këtë kontratë porosie nga të dy bashkëshortët. Vetëm në rast se është lidhur një akt tjetër noterial që deklaroi se ky aset nuk do të jetë pjesë e pasurisë së përbashkët bashkëshortore, pra nuk futet në rregjimin e përbashkët pasuror, atëherë ai mund të bëhet zotëruar 100% i tij . Për më tepër, që siç deklarohet edhe nga vet personi i lidhur (shuma prej 20.000 euro është dhënë nga kursimet e përbashkëta familjare) pra kontributor në të janë të dy bashkëshortët dhe kursimet e tyre ndër vite nga të ardhurat nga puna.

Në çdo rast Komisioni ka patur mundësi të verifikojë asetin në fjalë dhe të mos ketë asnjë pengesë/pamundësi vënie në dijeni të ekzistencës së astetit pasi ai është raportuar nga vet subjekti në vetdeklarimin e tij në njërin nga deklaratat e pasurisë në ILDKPKI (para fillimit të detyrës në funksionin aktual viti 2018) dhe më tej në deklaratën *vetting* 2018.

Trupa vlerësuese, vë në dukje, se në Ligjin *Vetting* 12/2018, nuk ka një dispozitë të shprehur lidhur me marrjen si dhe deri ku si provë nga ana e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të këtyre deklarimeve, fuqisë prapavepruese të vlerësimit të Komisionit për mënyrën e zbatimit të ligjit në kohën e plotësimit të deklaratave sipas ligjit specifik të ILDKPI, (bazuar në nenin 34 të ligjit 12/2018, pika 3 , ILDKPKI vë në dispozicion të gjitha informacionet që disponon si rezultat i deklarimit).

25. Nga hetimi financiar i burimit të krijimit të kësaj pasuri rezulton se:

Nga analiza e të ardhurave nga paga të znj. J.Ahmeti dhe të subjektit Bujar Ahmeti dhe të kursimeve të akumuluar nga familja sipas tabelës financiare si dhe shpjegimeve te subjektit, të shoqëruara me vërtetimet e punës dhe statement bankar, rezulton se bashkëshortja dhe subjekti kanë patur

gjendje për të paguar atë shumë prej 20.000 euro për porositjen e apartamentit si dhe në vijim, në të ardhmen për të likuiduar pjesën e mbetur të këstit (17.200 Euro, kjo bazuar në statement bankar¹² si dhe vet përgjigjet në pyetsor¹³ të subjektit për të ardhurat e deklaruara nga vet subjekti për vitet pasuese), pavarësisht se ky këst ende sot rezulton i pashlyer për arsyet e shpjeguara më lart.

A) V. PASURITË E LUAJTSHME TË BASHKËSHORTES J.AHMETI

26. Bashkëshortja e Subjektit ka deklaruar se ka patur dy automjete në pronesi në emër të saj, aktualisht automjetet i ka shitur.

1. Automjeti me targë AA 305HR blerë në 2013 në vlerën 1000(një mijë) euro dhe shitur me 2017 në vlerë 2500(dy mijë e pesëqind) euro¹⁴.

2. Automjet me targë AA 987 SU, blerë në 24.11.2017 në shumën 168.000(njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë)lek dhe shitur sipas kontratës dt.19.4.2018, në shumën 350.000(treqind e pesëdhjetë mijë) lek¹⁵.

3. Burimi i te ardhurave : kursime nga familja

➤ **Hetimi i Komisionit :**

Nga Zyrat Noteriale, Komisioni ka administruar kontratat e shitblerjes ku vertetohen deklarimet për tjetërsimin e automjeteve. Po ashtu edhe nga DPSHTRR konfirmohen të dhënat për automjetet.

- ❖ **Përputhet deklarimi i bashkëshortes se subjektit me dokumentet zyrtare lidhur me blerjen dhe shitjen e automjetit.**
- ❖ **Burimi i krijimit: nga kursimet familjare (deklaruar nga subjekti)**

Siç dhe pasyrohet nga tabela financiare, deri në vitin 2013, nga të ardhurat e përbashkëta familiare, rezulton kursimi i vitit 2013 që mbulon shumën monetare për blerjen e automjetit në vlerën 1000 (një mijë) Euro. Po ashtu edhe për blerjen e automjetit tjetër në vitin 2017 në vlerën 168.000(njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lek. Të dyja shitjet e këtyre automjeteve kanë qenë me përfitim të vlerave të shtuara, thuajse dyfish i vlerave të blerjes.

27. Likuiditete :

Bashkëshortja ka deklaruar se ka llogari rrjedhëse në Bankën Credins dhe rezulton me shumën 111.591 (njëqindë e njëmëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një)lek¹⁶.

Nga Banka Credins vërtetohet gjendja e mësipërme e deklaruar në datën 23.4.2018 , shumë e cila rezulton nga pagat rrjedhese.

28. Gjëndja CASH :

Deklaruesja, person i lidhur, deklaron gjendje Cash në shumën 600.000(gjashtëqind mijë) lek; Burimi nga shitja e makines Smart ne vlerën 350.000(treqind e pesëdhjetë mijë lek) dhe nga të ardhurat familjare.

¹² Vërtetim nr.*** prot., dt.20/04/2018 nga CREDINS bank; Kthim Pergjigje Banka Tirana nr. .***prot, datë 05/07/2019

¹³ Përgjigje pyetesorit me nr. .***prot., datë 26/01/2020 të cituar e plotë në faqen 12-13 footnote 11.

¹⁴ “Kontrate shitblerje pasurie te palujtshme”, nr.*** rep, nr.***kol., dt.25/03/2017

¹⁵ “Kontrate shitblerje automjet”, nr.***rep, nr.***kol., dt.19/04/2018

¹⁶ Shkresa nga Credins Bank “Kthim Përgjigje” nr.***prot, dt.26/08/2019

➤ **Hetimi i Komisionit :**

- a) Siç dhe analizuar në shitjen e makinës në vlerën 350.000(treqind e pesëdhjetë mijë) lek, si shitje fundore e automjetit në pronësi të saj dhe diferenca prej 250.000(dyqind e pesëdhjetë mijë) lek kursim, nga llogaritja financiare e familjes, rezulton se deri në datën 19.4.2018 kur është shitur makina dhe deri në plotësimin e deklaratës, rezulton se ka mjaftueshmëri të të ardhuve familjare deri në këtë ditë për shumën e akumuluar në vlerën 250.000(dyqind e pesëdhjetë mijë) lek .

Po ashtu, për krijimin e gjendjes Cash në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lek, nga veprimet e kryera (tërheqje shumash bankare në vlerat 500.000 (pesëqind mijë)lek më datë 20.4.2018 dhe 200.000(dyqind mijë) lek me datë 23.4.2018, nga gjendja fillestare në fillim të vitit 2018 në shumën 857.691(tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) lek si dhe nga të ardhurat e përfituara nga shitja e makinës Smart në vlerën 350.000(treqind e pesëdhjetë mijë) lek, konstatohet se mbulohet krijimi i kësaj gjendjeje cash.

29. DETYRIME :

Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se ka marrë kredi në vlerën 1.000.000(një milion) lek me afat 5 vjeçar, pranë Bankes Credins, disbursuar me dt.19.1.2018 . Kësti mujor 20.000 lek, paguar dy keste deri në plotësimin e deklaratës¹⁷.

➤ **Hetimi i Komisionit :**

Nga banka përputhet e dhëna e deklaruar me ekstraktin e bankës dhe shlyerjen e dy kësteve¹⁸ .

1. Bashkëshortja e Subjektit ka deklaruar se ka detyrime të pashlyera në vlerën 17.200 Euro për llogari të Kontrates se Sipermarrrjes nr. * dt. 22.7.2005, me sipermarres E.C.**

Shpenzimet për frymë sipas INSTAT		Për frymë	Konsumi për familje	Total të ardhurat	Diferencë të ardhura minus shpenzime për çdo vit	Vitet	Progresive fitimi për çdo vit deri në 2005
viti	1994		51.418	64.273	12.855	1994	
viti	1995		181.241	226.551	45.310	1995	58.165
viti	1996		280.061	350.076	70.015	1996	128.180
viti	1997	5.000	180.000	433.713	253.713	1997	381.893
viti	1998	5.000	240.000	624.193	384.193	1998	766.086
viti	1999	5.000	240.000	1.858.429	1.618.429	1999	2.384.515
viti	2000	108.000	432.000	888.236	456.236	2000	2.840.751
viti	2001	108.000	432.000	1.023.593	591.593	2001	3.432.344
viti	2002	93.864	375.456	1.453.409	1.077.953	2002	4.510.297
viti	2003	93.864	375.456	1.308.141	932.685	2003	5.442.982
viti	2004	93.864	422.388	1.786.866	1.364.478	2004	6.807.460
viti	2005/6 mujori I		273.893	717.529	443.637	2005	7.251.097
viti	2005/ 6mujori II	109.557	273.893	668.865	- 3.988.828	2005	3.262.269

¹⁷ Vërtetim nr.*** prot., dt.20/04/2018 nga CREDINS Bank

¹⁸ Shkresa "Kthim Përgjigje" nr.***prot, dt.26/08/2019 nga Credins Bank

30. LËVIZJE BANKARE TË BASHKËSHORTES:

- a) **Nga verifikimet bankare** si dhe nga deklarimi në deklaratën vetting 2018, trupa ka drejtuar pyetje për disa tërheqje të kryera nga bashkëshortja në llogarinë e saj bankare rrjedhese, në Banken Credins përkatësisht në vitin 2013 në shumën 300.000(treqind mijë) lek dhe në vitin 2017, në shumën 580.000(pesëqind e tetëdhjetë mijë) lek si dhe një tërheqje në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lek dhe riderdheje e shumën 90.000(nëntë dhjetëmijë) lek brenda ditës (dt.16.5.2013)
- b) *Nga përgjigjet në pyetsor¹⁹*, është sqaruar arsyeja e shumave të tërhequra sipas datave respektive që rezultojnë në gjendjen bankare dhe që janë kryer për vlerën 300.000 (treqindëmijë) tërheqje nga llogaria me qëllim blerje automjet viti 2013; vlera 100.000 është tërheqje për kryerje kontrolli shëndetësor dhe kryer derdhje përsëri në llogari vlera 90.000(nëntëdhjetë mije) lek në vitin 2013 si dhe vlera 580.000(pesëqind e tetëdhjetë mijë) lek tërhequr në vitin 2017 për rregullime të banesës si pasoje e amortizimit ndër vite.
- c) Duke qene se shuma 580.000 (pesëqind e tetëdhjetë mijë) lek tërhequr në vitin 2017, nuk ka dalë për përfundimin e punimeve është marre edhe një kredi në vlerë 1,000,000 (njëmilion) lek në Janar të vitit 2018 siç rezulton edhe nga deklarimi i bashkeshortes ne deklaratën Vetting 2018, si dhe nga vertetimi bankar për marrjen e kredisë nga ana e bashkeshortes, përcjellë në shoqërueset e deklaratës.

31. SHPENZIMET E DEKLARUESHME:

-) *Në pasqyrën shpenzimet e deklarueshme në deklaratën e vetingut, subjekti deklaron:*
-) *Shpenzimet për energji elektike dhe furnizim me ujë, telefoni fikse dhe shërbim celular për vitin 2017, për shtëpinë e banimit në Tiranë dhe detyrimet për shtëpinë në Sarandë;*
-) *Dokumentet që shoqërojnë deklarimin lidhur me shpenzimet e deklarueshme;*
-) *Librezat UKT, OSHË, Albtelekom²⁰*

➤ **Hetimi i Komisionit :**

- ❖ Verifikimi për ekzistencën e shtëpisë në Tiranë si aset i ligjshëm dhe që përputhet me gjetjet e hetimit, është bërë më lart.
- ❖ Ndërkohë që për mjaftueshmërinë e mbulimit të të ardhurave rezulton se nuk ka mopërputhje dhe se subjekti është i gatshëm në kohë të paguajë detyrimet mujore.

Në pasqyrën e shpenzimeve të deklarueshme në deklaratën Vetting, subjekti deklaron:

¹⁹ Kthim Përgjigje dhe dërgim dokumentacioni nr.*** prot datë 07/10/2019

²⁰ Fotokopje Libreza OSHË Tirana-I, Nr.Kontrate***, në emër të Bujar Ahmeti, Fotokopje Libreza UKT, Zona 15 Nr.Kontrate***, në emër të Bujar (Konati)Ahmeti; Fotokopje Libreza "ALBtelecom" nr.***telefoni (fix), në emër të Bujar Ahmeti

32. SHPENZIME PËR UDHËTIME

Udhëtimet për vitin 2015, 2016 dhe 2017 nga të cilat rezultojnë: Udhëtime të vajzës, djalit si dhe një udhëtim i vet subjektit për arsye pune të mbuluara nga vet organizatorët. Subjekti ka deklaruar vlerat e shpenzimeve për çdo udhëtim, kostot e biletave të udhëtimit si dhe mbulimin e shpenzimeve në ato raste kur janë mbuluar nga persona të tretë të njohur familjarë

➤ **Hetimi i Komisionit :**

-)] Rezultojnë se shpenzimet totale për udhëtimet jashtë shtetit tre vitet e fundit 2015, 2016, 2017 në total janë në shumën **302,209 (treqind e dy mijë e dyqind e dy)lek.**
-)] Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues lidhur me këto udhëtime duke paraqitur **ftesat për mbulimin e akomodimit dhe shpenzimeve të tjera në raste konkrete**²¹

33. Për të vërtetuar saktësinë e deklaramit të subjektit si dhe mjaftueshmërinë në burime të ligjshme për të përballuar këto udhëtime dhe shpenzimet përkatëse për to, Komisioni i është drejtuar DPPSH (TIMS) për të verifikuar hyrje –daljet.

34. Nga TIMS është administruar përgjigjia sipas të cilës konfirmohen të gjitha rrugët hyrëse dhe dalese nga territori i vendit në përputhje me deklaramin e subjektit²².

- ❖ *Sa i takon mbulimit të shpenzimeve, trupa në vlerësim të analizës financiare të kryer për këtë subjekt, del në konkluzionin se subjekti ka të ardhura për të përballuar këto shpenzime;*
- ❖ *Analizë financiare për secilin nga tre vitet 2015, 2016, 2017, si dhe 2018*²³

35. SHPENZIMET PËR ARSIMIMIN E FËMIJËVE

Subjekti ka deklaruar shpenzime për tre fëmijet (dy vajzat dhe djalin përkatësisht në shkollë të mesme jopublike dhe në Universitet jo publik e publik), të cilat shkojnë në total në vlerën 1.000.000 (një milion) lek.

➤ **Hetimi i Komisionit :**

-)] Pasi bëri analizën financiare rezultojnë se në total vlerat e shpenzuara për arsimimin e fëmijëve janë në vlerën 1.000.000 (një milion) lek dhe se këto vlerat monetare për likudimin e pagesave për arsim

²¹ Ftes, date 24/11/2015 nga shtetasi A.B, Gjermani; Deklaratë Noteriale nr.***repertori,nr.***koleksioni, dt.27/11/2015; Invitation Letter nga autoritetet Kroate, vizit pune Bujar Ahmeti

²² Shkresa "Kthim Përgjigje" nr.***prot.,dt.21/08/2019

²³ Shpenzuar 2015 shuma 50 euro* 139.74(kursi) =6,987 leke; 390 euro*139.74(kursi)=54,498 lek; Shpenzuar 2016 shuma 175 euro *137,36(kursi) =20,038 lek; Shpenzuar shuma 330 euro*137,36(kursi)=45,328 lek; Shpenzuar shuma 300 euro*137,36(kursi)=41,208 lek; Shpenzuar 2017 shuma 500 euro+500 euro=1000 euro*134,15(kursi)=134,150 lek.

kanë qenë të përballeshme për t'u mbuluar nga bashkëshortët sipas të ardhurave në vitet respektive.

Shpenzim sipas INSTAT	Për frymë	Konsumi për familjë	Shpenzime sipas DT-Vetting në vite	Total Shpenzime	Të ardhurat nga Paga në vitet e Policisë së Shtetit B.A	Të ardhurat e shpërblimeve+take solidariteti	Të ardhura nga paga neto+shpërblime J.A	Të ardhurat e B.A(vajza)	Total I të ardhurave	Diferenca e te ardhurave minus shpenzime per cdo vit	Progresive fitimi per vitet
2014	219.998	1.099.990	301.946	1.401.936	1.036.418	176.137	564.242		1.776.797	374.861	8.462.331
2015	224.276	1.121.380	321.096	1.442.476	1.126.256	6.300	570.196		1.702.752	260.277	8.722.607
2016	235.092	1.175.460	210.575	1.386.035	1.177.986		577.314		1.755.300	369.265	9.091.872
2017	198.587	992.933	952.150	1.945.083	1.192.702	127.000	763.908		2.768.985	823.902	9.915.774
2018	198.587	198.587	17.955	216.542	468.089		197.661	60.000	725.750	509.208	10.424.983

36. Dietat e përfituara nga subjekti gjatë viteve të punës për shkak të trajtimit policor të veçantë në përputhje me funksionin e kryer në policinë e shtetit.

37. Komisioni ka konstatuar nga statement bankar, të hyra përveç shpërblimeve në formën e vlerave monetare të konsiderueshme edhe për trajtim ushqimor, veshmbathje dhe dieta për shkak të shërbimeve të kryera nga subjekti në operacione të ndryshme policore.

38. Komisioni sqaron se këto vlera nuk janë llogaritur në të hyrat përfituese të subjektit dhe familjes së tij për shkak të legjislacionit mbi të ardhurat dhe kuadrit ligjor lidhur me të specifikisht:

Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998,“Për Tatimin mbi të Ardhurat”(i ndryshuar) si dhe Udhëzimit nr.5, dt.30.01.2006 (i ndryshuar), ku përcaktohen të ardhurat e tatueshme, në rastin e dietave apo formave (antidotë) ato konsiderohen si të ardhura në natyrë në formën e ushqimeve sipas parashikimeve në legjislacionin e posaçëm, në këtë rast Ligji për Policinë e Shtetit dhe për rrjedhojë ato duke qenë se janë të ardhura të patatueshme sipas nenit 8 të ligjit dhe të udhëzimit të dalë në zbatim të tij, si rrjedhojë ato konsiderohen si shpenzime të panjohura.

39. Megjithatë Komisioni mban rezervën e një shume të panjohur kursimesh eventuale që për shkak të natyrës së punës së subjektit, shpeshësisë së shërbimeve për shkak të funksionit dhe specifikimeve të ligjit të posaçëm, vlerave të akorduara në formën e parave, mund të krijojnë një shumë të caktuar kursimesh nga subjekti ndër vite rast pas rasti, por që janë të pamundura objektivist për t'u përlllogaritur.

Në përfundim të analizës financiare në tërësi :

<i>Total të ardhurat (paga + shpërblime b.shortet) vitet 1994-2018</i>	<i>Total shpenzimet 1994-2018 (Instat + tjera)</i>	<i>Rezultati ndër vite (1994 -2018)</i>
<u>33.649.952 lek</u>	15,010,766 konsumi familjar + 6,123,236 udhëtime , arsim Fëmijët, blerje shtëpi, arredim shtëpië <hr/> 21,140,924 lek	<u>12,509,028 lek</u>

<p><i>Total asete (pasuri palujtshme + cash + depozitë deri datën e dek Vetting 2018)</i></p> <p><i>1.900.000 lek shtëpi banimi Tiranë</i> <i>37.200 Euro x 126.72 kursi i muajit Maj 2018=4.713.984 lek shtëpi banimi Sarandë</i> <i>1.000.000 lek depozitë kursimi</i> <i>600.000 lek Cash bashkëshortja</i> <i>111.591 lek llogari rrjedhese b.shortja</i> <i>244.042 lek llogari rrjedhese subjekti</i></p> <hr/> <p style="text-align: center;"><i>8.567.617 lek total</i></p>	<p style="text-align: center;"><i>Total detyrime deri datën e dorëzimit të deklaratës vetting 2018:</i></p> <p><i>974.234 lek kredi 5 vjeçare</i> <i>17.200 euro detyrim i palikuiduar (konvertuar me kursin e muajit maj 2018, si kohë e dorëzimit të deklaratës 3.5.2018 , Kursi euro: 126.72 = 2.179.584 lek)</i></p> <hr/> <p style="text-align: center;"><i>3.153.818 lek total</i></p>
--	--

❖ **Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror në përputhje me pikën 6, të nenit 34 të Ligjit nr. 12/2018, konstaton:**

- a) *deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë në përputhje me Ligjin,*
- b) *ka burime financiare të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë,*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë,*
- d) *nuk ka kryer deklaram të rremë,*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

B) I. KONTROLLI I FIGURËS

40. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të vlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimin e atyre që janë përfshirë apo kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë veprimtari kriminale.

41. Subjekti Bujar Ahmeti në zbatim të nenit 36, pika 2 e Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” (këtu e në vijim ligji i vlerësimit) ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në datën 3.5.2018, brenda afatit ligjor.
42. Kontrolli i figurës për subjektin e vlerësimit Bujar Ahmeti, është kryer bazuar në përcaktimet e nenit 4, pika 1, gërma “b” dhe neneve 35-42, 48 dhe 51 e 52 të parashikuara në Ligjin e Vlerësimit nr.12/2018 (i ndryshuar).
43. Procedura për kontrollin e figurës është kryer sipas përcaktimeve të neneve 36 -37 për bashkëpunimin me institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, informuese dhe verifikuese në vend dhe jashtë tij, verifikimit të informacioneve nga publiku në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo personave të lidhur, si dhe vlerësimit të provave, informacioneve të klasifikuara dhe informacioneve të tjera të disponueshme që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, përfshirë rrethanat rënduese dhe lehtësuese bazuar në ato që parashikohen në nenin 38-41 të Ligjit.
44. Trupa e vlerësimit ka proceduar në dy momente të rëndësishme të verifikimit të figurës sipas ligjit 12/2018:
-) Fillimisht është administruar dhe verifikuar Formulari i kontrollit të figurës i plotësuar nga subjekti si detyrim i Ligjit 12/2018.
 -) Më tej janë administruar përgjigjet nga institucionet ligjzbatuese, verifikuese dhe informuese.
45. Në Deklaratën për Kontrollin e Figurës, Subjekti i vlerësimit, Bujar Ahmeti, ka deklaruar si më poshtë:
- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër;
 - Nuk është njohur me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka pasur apo ka të regjistruar në gjendjen civile;
 - Nuk ka pasur shtetësi tjetër;
 - ***Të dhëna për vendbanimin : Të njëjtën adresë që ka deklaruar edhe në formularin e deklaramit të pasurisë;***
 - ***Të dhëna për arsimin dhe kualifikimet: të njëjta me ato të deklaruara në formularin e vlerësimit profesional;***
 - ***Të dhëna për Punësimin: të njëjta me ato të deklaruara në formularin profesional;***
 - ***Të dhëna për Sigurinë: Në pjesën 5 të këtij formulari subjekti i është përgjigjur të 18 pyetjeve me përgjigjen negative “jo”.***

➤ **Hetimi i Komisionit :**

Për të kontrolluar figurën dhe saktësinë e deklaramit për subjektin e vlerësimit, Komisioni ka kryer veprime hetimore duke kërkuar të dhëna me anë të korrespondencës zyrtare pranë këtyre institucioneve verifikuese dhe ligjzbatuese:

- DSIK
- SHISH
- SHCBA
- Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimin e Shtetit
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile
- Prokuroria e Përgjithshme (për tre aspekte të kontrollit lidhur me : Çështjen e zbatimit të ligjit të dekriminalizimit, bashkëpunimin në kuadër të Task Forcës, përgjigjet e kërkesës për procedime penale, në hetim apo masa /urdhra ndalimi ndërkombëtar)etj.
- Avokati i Popullit
- Sistemi TIMS
- Sindikata e Policisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, *të cilat konfirmojnë:*

46. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me shkresën nr.*** prot, datë 17/7/2019, konfirmon se shtetasi Bujar Zenel Ahmeti, është pajisur me Çertifikatë Sigurie Personelit (CSP) të nivelit “Tepër sekret” me datë lëshimi 13/08/2015 i vlefshëm deri në datën 11/08/2020.

47. Institucioni ligjzbatues me shkresën nr.*** prot, 16/07/2019 konfirmon se nuk disponon të dhëna/materiale referuese/procedime penale në ngarkim të subjektit të vlerësimit Bujar Zenel Ahmeti dhe personave të lidhur me të.

48. Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamenti i Policisë Kriminale, me shkresën nr.**** prot, datë 23/09/2019, në mënyrë të përgjithshme, janë administruar përgjigjet e prokurorive të rretheve (Dibër, Elbasan, Shkodër, Pukë, Përmet, Kurbin , Gjirokastrë, Mat, Tropojë, Korçë, Durrës, Kavajë, Lezhë, Berat, Krujë, Vlorë, Pogradec , Lushnje, Sarandë, Tiranë, Fier), nga ku në listën me 40 subjektet e para të iniciuara për verifikim nga ana e KJV, ndër to edhe subjekti Bujar Ahmeti, nuk rezulton se ka të dhëna sipas kërkimit për rregjistrime/procedime penale, urdhra ndalimi, masa të sigurimit personal, marrë në cilësinë e të pandehurit apo person nën hetim, apo urdhra ndalimi ndërkombëtar.

49. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit me shkresën nr.**** prot, datë 14/08/2019, informon Komisionin, për vendimin nr.****, datë 07/08/2019 e marrë nga AIDSSH për subjektin e vlerësimit Bujar Zenel Ahmeti.

Në këtë vendim AIDSSH ka vendosur:- *Të informojë Institucionin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, se nga verifikimet e kryera deri tani për shtetasin Bujar Zenel Ahmeti, nuk rezulton të ketë qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, të ketë qenë anëtar, bashkëpuntor ose i favorizuar nga ish – Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991, në zbatim të Ligjit 12/2018, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”.*

50. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr.**** prot datë 21/08/2019 nëpërmjet verifikimeve në TIMS na konfirmon të gjitha hyrjet-daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë për periudhën 01/05/2004-18/08/2019 për subjektin dhe personat e lidhur me të.

- Komisioni komunikoi me shkresë me DPSHTRR për verifikimin e targave të konfirmuara nga TIMS.

51. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria e Regjistrimit të mjeteve, me shkresën nr.**** prot, datë 14/10/2019 me kërkesën e KJV ka verifikuar të gjitha targat e konfirmuara nga sistemi TIMS për të gjitha hyrjet-daljet nga Territori i Republikës së Shqipërisë.

- Nga verifikimi i targave dhe personave përgjegjës të këtyre automjeteve rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë udhëtuar apo kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale.

52. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Gjyqësore, me shkresën dt. 21/01/2020, përcjellë gjithë informacionin e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Prokuroritë e Gjykatave të Rretheve Gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm. Në të gjitha informacionet e ardhura nuk rezulton që ndaj shtetasit Bujar Zenel Ahmti të jetë regjistruar kallëzim apo procedim penal në ngarkim të tij.

53. Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Departamenti për Shërbimet Mbështetëse, me shkresën nr.**** prot, datë 21.10.2019, ka përcjellë formularin e vetdeklarimit bazuar në kërkesën e Komisionit për vënie në dispozicion të formularit të vetdeklarimit në zbatim të Ligjit nr. 138/2015 (i ndryshuar) dhe Vendimit të Kuvendit 17/2016 të dalë në zbatim të tij, për subjektin Buajr Ahmeti.

- Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka raportuar ndonjë të dhënë apo të kishte ndonjë fakt /indicie për të cilën duhej të fillonte verifikimi i thelluar sipas kriterëve dhe kushteve të ligjit 138/2015.

Pavarësisht këtij fakti, si dhe në vijim të koordinimit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Përgjithshme e cila ka orientuar në shkresën e saj me nr. ****, dt.9.10.2019, përcjellë Komisionit nga Prokurorja e Përgjithshme si më poshtë:

“Përfshirja në verifikim të thelluar sipas Ligjit 138/2015, do të ndërmerret vetëm nëse ka nevojë për verifikim të thelluar për shkak se mund të rezultojë që ka indicie mbi bazën e një kërkesë ose kryesisht kur kanë të dhëna apo fakte përfshirë edhe ato të njohura botërisht për një të kaluar kriminale, si dhe për rastet kur personat e kanë deklaruar te rubrika e të dhënave për të kaluarën e tyre kriminale, por organi përgjegjës vlerëson se duhet përcjellë për të verifikuar saktësinë e deklarimeve”.

Edhe pse rezultoi deri në kohën e zhvillimit të këtij hetimi nga trupa vlerësuese se deri më tani nuk ka rrethana, ngjarje apo të dhëna zyrtare si dhe indicie për të cilat të diponohen informacione në ngarkim të subjektit, për të cilin duhen nisur hetime të thelluara nga organet ligjzbatuese, është

kërkuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme verifikimi i formularit të dekriminalizimit për subjektin Bujar Ahmeti.

Ky verifikim është kërkuar bazuar në kërkesën ligjore të Ligjit nr. 12/2018, gërma “dh”, pika “1” e nenit 38, të tij sipas të cilit, në vlerësimin e rrethanave për kontrollin e figurës, trupat e KJV mbajnë në konsideratë ndër të tjera edhe: *“verifikimin e procedimeve penale dhe administrative ndaj punonjësit, brenda dhe jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”*.

Duke qenë se ligji i vlerësimit, si një ligj i posaçëm referon në kontrollin dhe zbatimin e ligjit të dekriminalizimit, pavarësisht kohës dhe rasteve se kur mund të kryhet ky vlerësim nga ana e organit përgjegjës, në këtë rast Prokuroria e Përgjithshme, u inicua me kërkesë të Komisionit verifikim i thelluar për subjektin e vlerësimit, Z.Bujar Ahmeti dhe në vijimësi të ecurisë së një afati të arsyeshëm tremujor, Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë pranë KJV, përgjigjet përkatëse.

54. Në kthim përgjigje të shkresës së Komisionit me nr*****Prot., date 18/09/2019 drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, me lende “Kërkim të dhenash për procesin e vlerësimit”, për subjektin e vlerësimit Z.Bujar Ahmeti, është administruar në protokollin e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit shkresa me nr.***** Prot, date 27/12/2019 më lende “Kthim Përgjigje” përcjellja e informacionit nga:

✓ 20 Prokurori pranë Gjykatave të Shkallës së Parë së Rretheve: Lushnjë, Gjirokastër, Sarandë, Korçë, Fier, Kukës, Elbasan, Vlorë, Kavajë, Përmet, Berta, Kurbin, Durrës, Lezh, Mat, Tropojë, Pukë, Dibër, Krujë, Pogradec të protokolluara prane Prokurorisë së Përgjithshme me Nr.2445/fraksion i fundit 24 Prot., datë 24/12/2019.

Nga informacionet e përcjella rezulton se: *nga verifikimet e kryera shtetasi Bujar Zenel Ahmeti, nuk ka qënë person nën hetim /i pandehur apo i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme të hetuara nga këto prokurori, nuk ka të regjistruar kallëzime/referime/procedime penale, nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale për periudhën e kërkuar.*

55. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me datë 10/07/2019 është administruar përgjigjia për verifikimin e gjëndjes gjyqësore ku rezulton se subjekti nuk ka qenë i dënuar.

56. Zyra e Gjëndjes Civile, me shkresën nr.**** Prot, datë 09/10/2019, vërtetohet se subjekti nuk ka ndërruar gjeneralitetit dhe as nuk ka ndërruar banesë që prej vitit 2005 kur ka blerë apartamentin në Tiranë dhe që është deklaruar në deklaratën Vetting.

57. Në referim të shkresës së fundit administruar në KJV nr. ***** prot , datë 5/2/2020, nga institucion ligjzbatues, Komisioni nuk konstaton se ka patur të dhëna të qënësishme, të vërtetuara në fakte dhe prova për ndonjë veprimtari të kundërligjshme të subjektit.

58. Avokati i Popullit, me shkresën nr.**** Prot, datë 7/8/2019, nuk konfirmon të ketë pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin Bujar Ahmeti.

59. Pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, nuk janë paraqitur denoncime nga publiku ndaj subjektit të vlerësimit Bujar Ahmeti, për shkelje të rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar).

60. Në datën 05/02/2020 subjekti i është nënshtruar vlerësimit psikologjik bazuar në Ligjin 12/2018 i ndryshuar (neni 38/2). Në përfundim të raportit të vlerësimit psikologjik është arritur në konkluzionin se subjekti Bujar Ahmeti:

- Aktualisht nuk paraqet probleme të shëndetit mendor ndaj është mendërisht i aftë të funksionojë në aspektin okupacional, ndërpersonal, social dhe familjar.
- Paraqet marrëdhënie të stabilizuara personale dhe ndërpersonale.
- Subjekti nuk paraqet problematika të personalitetit, që mund të çënojnë realizimin e detyrave dhe aktivitetin e tij në tërësi si dhe shfaq shkallë të lartë të funksionimit në plotësimin e këtij aktiviteti.

❖ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa Vlerësuese, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit të vlerësimit Nr. 12/2018 (i ndryshuar), nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjensitë ligjzbatuese, si dhe vlerësimit psikologjik, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr.12/2018 (të ndryshuar), arriti në konkluzionin se:

❖ **Subjekti i vlerësimit Bujar Ahmeti;**

- ✓ *ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- ✓ *nuk ka informacion në deklaramin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në veprimtari kriminale;*
- ✓ *punonjësi është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*

C)I. VLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE

61. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit të vlerësimit Nr. 12/2018 (i ndryshuar) dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.

62. Subjekti Bujar Ahmeti në zbatim të nenit 44, pika 1 e Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, ka dorëzuar formularin e vetëvlerësimit të aftësive profesionale, në datën 3.5.2018 brenda afatit ligjor.

❖ **Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në tre elemente:**

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018;
2. Të dhënat nga institucionet përgjegjëse që konfirmojnë nivelin arsimor dhe kualifikimet përkatëse, ecurinë në karrierë të subjektit nga dosja e personelit dhe nga vërtetime e akte të tjera administrative

të emerimeve në funksione dhe dhënies së gradave respektive, ecurinë disiplinore, vlerësimet e punës individuale në tre vitet e fundit;

3. Dokumentet e përgatitura nga punonjësi sipas nivelit respektiv menaxherial apo/ose operacional;
4. Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 7 vjet;
5. Subjekti i vlerësimit Bujar Ahmeti në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018 ka ushtruar funksionin e “*Drejtorit të Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale*”.

❖ Për të vlerësuar aftësinë profesionale për subjektin e vlerësimit, Komisioni ka kryer procedurat duke kërkuar të dhëna me anë të korrespondencës me **nr. 32** prot, **dt. 2019**, pranë këtyre institucioneve:

- 📁 Drejtoria e Standarteve Profesionale në Policinë e Shtetit;
- 📁 Drejtorive arsimore dhe Ministrisë së Arsimit;
- 📁 Akademisë së Sigurisë;
- 📁 Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;
- 📁 Dhomës Kombëtare të Avokatisë;
- 📁 Fakultetit të Drejtësisë;
- 📁 Prokurorive pranë rretheve për efekt të kordinimit dhe bashkëpunimit si institucione ligjzbatuese
- 📁 Gjykatave (në rastet e proceseve gjyqësore të inicuar për masat disiplinore apo per grada).

❖ **Në lidhje me Vlerësimin e nivelit të arsimimi të subjektit të vlerësimit rezulton se:**

Subjekti i vlerësimit është diplomuar:

- Vitet 83-87, *Shkolla e Mesme “Kristo Isak” Berat, dega Ekonomist Agrare;*
- 88-1990, *Shkolla 2 vjeçare e Policisë kryer në Tiranë, Titulluar “Punonjës Policie”;*
- 91-96, *Instituti i Lartë i Policisë, sistemi 4 vjeçar, Titulluar “Specialist i Lartë Policie”;*
- 96-2003 *Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë Titulluar Jurist;*
- 2004 *Titulluar Avokat, Dhoma e Avokatisë, Tiranë.*

Në kuptim të legjislacionit ndër vite për Policinë e Shtetit dhe në Ligjin në fuqi 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” (i ndryshuar), trupa e vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në policinë e shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecurisë në karrierë të tij, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe /apo ushtron.

Në pikat “2 dhe 3” të nenin 44 të Ligjit 12/2018, përcaktohet se: “*Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 7 (shtatë) vjet*”.

❖ **Në 7 (shtatë) vitet e fundit subjekti i vlerësimit Bujar Ahmeti, ka punuar në funksionet si më poshtë:**

- Bazuar në urdhrat e emërimit në funksione të ndryshme në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ndër vite që prej vitit 1990 e deri në vitin 2010, kryesisht ka mbajtur në mënyrë të vazhdueshme dhe konstante funksione dhe pozicione në fushën e shërbimit të Drejtorisë së

Forcës së Posaçme Operacionale për një kohë të gjatë, si Komandant Toge, Komandant Skuadre/ i Repartit të Gatshëm Briksu, Komandantit të Reneas, Shef Shtabi dhe Komandant FNSH Fier;

- Nga viti 2010-2014 Specialist Trajnimesh dhe Stervitje në sektorin e Forcave të Posaçme Operacionale;
- Nga 2014-2015 Shef Sektori i Krimeve në Drejtoritë Vendore Kukës e Durrës;
- Nga 2015-2018 Specialist dhe Shef Sektori në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale dhe së fundmi që nga shkurti 2018, Drejtor i Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale.

❖ **Procesi i fitimit të gradës :**

Shkorja “c”, Pika “5” e nenit 45 e ligjit të vlerësimit Nr 12/2018 (i ndryshuar), përcakton se: *“Objekt i vlerësimit të afësive profesionale janë edhe ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi”.*

- ❖ Urdhrat e emërimit janë shoqëruar edhe me funksionet dhe gradat policore të përshtatura rast pas rasti për funksionin si dhe rastet e ekuivalentimit të tyre sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Subjekti që në kohën e emërimit për herë të parë në policinë e shtetit, ka patur gradat :

Në vitin 1990 : Oficer;
Në vitin 1991 : Nëntoger;
Në vitin 1996 : Toger ;
Në vitin 1997 : Kapiten;
Në vitin 1998 : Kapiten i pare;
Në vitin 2000 : Major;
Në vitin 2003 : Komisar;
Në vitin 2008 : Kryekomisar;
Në vitin 2017 : Drejtues;

❖ **Komisioni Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:**

Trupa vlerësuese analizoi legjislacionin e kohës për dhënien dhe fitimin e gradave nga ku konkludon se gradat Kapiten, Kapiten i Parë, Major, Komisar dhe Kryekomisar janë dhënë bazuar në Ligjin e Policisë, në Ligjin e Gradave të kohës dhe akteve nenligjore që përcaktojnë procedurat përkatëse të propozimit dhe miratimit si dhe ekuivalentimin e funksioneve me gradat.

- ✓ **Fitimi i Gradës Major** është bërë bazuar në Ligjin 8643/ 2000 “Për gradat në policinë e shtetit”, dhe në propozimin e titullarit në përputhje me përshtatshmëinë e funksionit organik me gradën ekuivalente si dhe në vlerësimin e rezultateve dhe aftësive profesionale të shfaqura në detyrën e Zvkomandantit dhe Shefit të Shtabit të Repartit Renea.
- ✓ **Fitimi i Gradës Komisar**, me Urdhrin e Ministrit të kohës në vitin 2003, subjektit me funksion Komandat i Repartit Renea *“I jepet grada Komisar”*

Trupa vlerësuese në analizë të legjislacionit përkatës të kohës, konkludon se dhënia e gradës nga Major në Komisar është kryer bazuar në VKM 64, dt.2.2.2001 *“Për Inkuadrimin i Gradës Ushtarake në Gradë Policore (pikat 1, 2, 3) dhe në zbatim të Nenit 22 të Ligjit 8553 datë 25/11/1999 “Për Policinë e Shtetit”, Nenet 7,14,26 të Ligjit 8643 datë 20/07/2000 “Për Gradat e Policisë së Shtetit”.*

- ✓ **Fitimi i Gradës Kryekomisar**, me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit në vitin 2008, subjektit me funksion Komandant i Repartit FNSH Fier, *“I jepet grada kryekomisar”.*

Trupa vlerësuese analizoi legjislacionin përkatës të kohës dhe konkludoi se dhënia e gradës nga Komisar në Kryekomisar është kryer bazuar në Ligjin 9749/2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe VKM 803 /2007 “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në policinë e shtetit” dhe ekuivalentimi i tyre me gradat.

Komisioni konstaton se me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9749/ 2007 “Për Policinë e Shtetit”, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka filluar procesin administrativ për ekuivalentimin e gradave policore sipas ligjit të ri. Subjektit i është ekuivalentuar grada në përputhje me VKM nr. 803, datë 21.11.2007 “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në policinë e shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”. Në këtë vendim është bërë ekuivalentimi i gradave, i shoqëruar dhe me një tabelë shoqëruese ku përbri “ish gradës së vjetër” është vënë “grada ekuivalente” që do të marrë punonjësi i policisë.

Gjithashtu në dosjen e personelit, gjendet edhe propozimi i Komisionit Kalimtar për Kalimin në Sistemin e Ri të Gradave i ngritur në DPPSH, ku rezulton se janë kryer procedurat ligjore në respektim të urdhrit të Ministrisë të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për organizimin dhe funksionimin e komisioneve kalimtare.

Subjekti në kohën e fitimit të kësaj grade plotësonte 2/3 e vjetërsisë së shërbimit për dhënien e gradës së re policore dhe kishte 17 vite e 2 muaj pune deri në vitin 2008 kur i propozohet Grada “Kryekomisar”.

- ✓ **Fitimi i Gradës Drejtues**, rezulton se subjekti ka fituar gradën policore “Drejtues” bazuar në Urdhrin e Drejtorit të Policisë së Shtetit me nr.****, dt.26.4.2017.

Në këtë urdhër, përcaktohet se grada “**Drejtues**” është dhënë bazuar në Vendimin Nr. 903, dt.8.3.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë marre formë të prerë më datë 9/4/2017. Rezulton se ky vendim nuk është ankimuar nga ana institucionit të Policisë së Shtetit.

➤ **Hetimi i Komisionit**

Rezulton se subjekti Bujar Ahmeti, që nga koha e gradës pararendesë “Kryekomisar” të dhënë në vitin 2008 (bazuar në Urdhrin nr.****, dt.13.6.2008) të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë deri në vitin 2017 ka mbajtur rreth 9 vite (dy vite komandant i Reneas, 6 vite specialist trajnimesh në Sektorin e Forcës Operacionale) dhe me pas prej datës 6/4/2016 me Urdhër nr. ****, datë 6/4/2016 është emëruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në detyrën Shef Sektori në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Përgjithshme për Hetimin dhe Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda në Policinë e Shtetit. Ky funksion bazuar në Ligjin 108/2014 dhe VKM 892/2016, i korrespondon grada ekuivalente ose në përputhje me funksionin e “Shefit”, pra grada “Drejtues”.

Nisur nga ky parashikim ligjor, siç dhe konstatohet nga dosja e personelit, subjekti i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Policisë së Shtetit për dhënien e gradës drejtues, pasi arsyet se kjo gradë i korrespondon funksionit organik Shef i Sektorit në Forcën e Posaçme Operacionale në DPPSH.

DPPSH është përgjigjur se nuk mund ta zgjidhë pozitivisht kërkesën për arsye se ecuria në karrierë e punonjësve të Policisë së Shtetit rregullohet me Ligjin 108/2014 “Për policinë e shtetit” dhe ku sipas nenit 54 dhe 55 të këtij ligji, fitimi i gradës mundësohet vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces konkurrimi, pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara me ligj.

Në këto kushte subjekti i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës duke kërkuar detyrimin e Policisë së Shtetit t'i njohë dhe japë gradën policiore nga "Kryekomisar" në "Drejtues", kjo në përputhje me gradën e funksionit që mbahet sipas ligjit dhe akteve nënligjore.

Gjykata ka legjitimuar të drejtën e subjektit për t'ju drejtuar gjykatës bazuar në përcaktimet e nenit 32²⁴ të Kodit të Procedurës Civile si dhe të Ligjit 49/2012^{25, 26} për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative:

Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, arsyeton se si organ administrativ i pavarur që është ngritur dhe funksionon në bazë të një ligji të posaçëm për vlerësimin kalimtar të punonjësve të policisë së shtetit ku ndër të tjera verifikon edhe mënyrën e dhënies/fitimit të gradave të larta policiore, nuk mund të gjykojë mbi një vendim gjykate të formës së prerë, kjo në kuptim të normës kushtetuese se pushtetet ekzekutive, gjyqësore dhe legjislativ janë të ndara dhe të pavarura në punën e tyre dhe se çdo vendim gjykate i formës së prerë është i detyrueshëm për njohje dhe zbatim nga palët. Asnjë organ tjetër përveç një gjykate më të lartë nuk mund të kundërshtojë vendimet e gjykatave.

Nga praktika e fitimit të gradës së subjektit përmes shqyrtimit gjyqësor dhe në referim të procedurave që normon legjislacioni i policisë së shtetit për kriteret dhe mënyrat e dhënies së gradës pasardhëse, trupa vlerësuese ka konstatuar se ka patur problematikë dhënia e gradës në organizatën e Policisë së Shtetit. Kjo për faktin se siç evidentohet edhe nga vendimi i gjykatës por edhe nga të dhënat e dosjes së personelit, **është në kundërshtim** me nenin 50/2 të Ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014 në të cilin është përcaktuar: *"... Sistemi i gradave, sipas këtij ligji, paraqitja, forma, emërtimet dhe mbajtja e tyre janë e drejtë vetëm e Policisë së Shtetit.*

Subjekti nga ana formale-ligjore, duket se i ka plotësuar kushtet për të kaluar në procesin e fitimit të gradës nga kryekomisar në drejtues.

Komisioni vlerëson se në kohën kur subjekti ka paraqitur kërkesë për fitimin e gradës "Drejtues", ai ushtronte funksionin e Shefit të Sektorit në Forcën e Posaçme Operacionale në Drejtorinë e Përgjithshme për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda në drejtorinë e Policisë së Shtetit dhe mbante gradën "Kryekomisar".

Ndërkohë, referuar legjislacionit respektiv dhe VKM përkatëse që detajon funksionet me gradat ekuivalente (konstatohet se në vendimin e gjykatës referohet një VKM e shfuqizuar) ndërkohë që VKM-ja që përcakton për çdo funksion gradat respektive është VKM nr.892 /2016 e cila ka dalë si akt nënligjor në zbatim të Ligjit 108/2014, nenit 61 të tij. Kjo VKM është publikuar që në 21 Dhjetor 2016 çka në kohën e shqyrtimit gjyqësor ishte në fuqi.

Sipas kësaj VKM-je, funksioni i Shefit të Sektorit në Drejtorinë e Përgjithshme i korrespondon Grada "Drejtues". Në kushtet ku për të patur të drejtën e konkurrimit të punonjësve sipas nenit 54 dhe 55 të Ligjit 108/2014, duhet që:

- punonjësi të ketë plotësuar vjetërsinë për efekt konkurrimi për fitimin e gradës në shërbim nga grada "Kryekomisar" në gradën "Drejtues" 5 vite;
- të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës jo më të ulët se 70 të vlerësimit të përgjithshëm;
- të përmbushë kriteret për pozicionin e punës;

²⁴ *Padia mund të ngrihet:* a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur;

²⁵ 15/a, Ligji 49/2012, për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative;

"Cdo subjekt që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik"

²⁶ 17 pika 1 gërma ç, e ligjit 49/2012, ligji për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative "për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrative, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka patur kërkesë".

"për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrative, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka patur kërkesë".

- të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rëndë, sipas aftit të përcaktuar në ligj;
- të ketë përfunduar ciklin e parë të studimeve në arsimin e lartë;
- të ketë përfunduar trajnimin e detyrueshëm për gradë;
- të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal;
- të mos ketë filluar procedimi disiplinor për shkelje të rëndë.

Dhe në referim të nenit 54 të ligjit përcaktohen procedurat që zhvillon organizata ku përcaktohen:

- Proces vlerësimi konkurrues nga një Komision Gradimi;
- Evidentimi për çdo vit i nevojave për çdo gradë, për vitin pasardhës, miratimin e urdhrin nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, në varësi të nevojave dhe prioriteteve, për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës respective; Fitimi i gradës bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë dhe vetëm për gradën pasardhese.

Sa më lart, Komisioni konstaton se organizata e policisë ka çeduar për të nisur procedurat e konkurrencës dhe kështu për t'i dhënë mundësinë atyre punonjësve të cilët plotësojnë edhe kriteret e vjetërsisë në shërbim dhe të funksionit respektiv dhe i nënshtrohen rregullave ligjore për konkurrueshmërinë dhe fitimin e saj.

Në këtë mënyrë nuk është zbatuar një pjesë shumë e rëndësishme e dispozitave ligjore të cilat i japin atributet vetëm policisë së shtetit të vlerësojë dhe japë gradat pasardhëse punonjësve të policisë dhe jo nëpërmjet pasivitetit dhe mosangazhimit procedural të policisë për të zbatuar ligjin duke detyruar subjektin për kërkimin e të drejtës në gjykatës e cila vihet në lëvizje dhe jep një të drejtë të mohuar /refuzuar vetëm bazuar në kërkesën e vet individit.

Pavarësisht sa më lart, ashtu siç arsyetohet edhe në vendimin e gjykatës për rastin e subjektit të vlerësimit, por edhe nga vet analizimi i fakteve të rastit me përcaktimet ligjore, subjekti Bujar Ahmeti i plotësonte kushtet që të ishte kandidat potencial për të fituar gradën pasardhëse “*Drejtues*”.

❖ **Në përfundim, në lidhje me procesin e fitimit të gradave Komisioni Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se:**

Dhënia e gradave policore, Oficer; Nëntoger; Toger; Kapiten; Kapiten i Parë; Major; Komisar; Kryekomisar dhe Drejtues; janë bërë në përputhje me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akte nënligjore në fuqi dhe funksioneve që ka kryer subjekti ndër vite.

C) II. VLERËSIMET E PUNËS

63. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. *****Prot datë 4/9/2019, konfirmon se Drejtoria e Standarteve Profesionale bën vlerësim performance të strukturave policore parashikuar në nenet 96-104 të Regullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr.750, datë 19.9.2015, sipas standarteve të miratura dhe pasqyrohet në vlerësimet e rezultateve individuale të punës të administruara në dosjen personale të punonjësit.

64. Në dosjen e personelit të subjektit , gjenden vlerësimet e performancës për vitet 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018.

65. Bazuar në sistemin e vlerësimit dhe pikëzimit të rezultateve të punës për performancën vjetore të punonjësit të policisë, rezulton se subjekti është vlerësuar përgjithësisht në të gjitha vitet me pikët maksimale për punën e kryer. Në vlerësimet e eprrorëve thuhet se :

“Ka aftësi të mira drejtuese dhe organizative, shfaq integritet dhe standarte të larta etike, krenohet me skuadrën dhe promovon performancën e skudraës. I përkushtuar për zhvillim profesional. korrigjon gabimet, respekton dhe ruan konfidencialitetin, respekton rregullat e etikës profesionale.

❖ **Vlerësimi mbi tre dokumentet e përgatitura nga subjekti përkatësisht:**

66. Me shkresën Nr.*****prot., date 09/08/2019, është përcjelle fotokopje e dosjes se personelit dhe të dhënave të tjera personale të specifikuar për subjektin Bujar Ahmeti ku janë administruar plane pune/urdhra shërbimi dhe raporte shërbimi në vite të ndryshme të hartuara dhe/ose të miratuara nga subjekti në ushtrimin e funksionit të tij respektiv, në cilësinë e Komandanit të Repartit të Reneas, Shefit të Sektorit të Forës së Posaçme Operacionale dhe Drejtorit të kësaj force.
67. Për shkak të natyrës së punës së subjektit në sektorin e forcës së posaçme operacionale që ai ka drejtuar, këto akte që kanë të bëjnë me operacione të veçanta të individualizuara për kapjen dhe arrestimin e personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe me precedent kriminale, si dhe për ndjekjen dhe finalizimin e operacioneve të procedimeve të ndryshme penale të Prokurorive pranë Gjykatave për krimet e rënda, janë të nivelit sekret.

Trupa vëren se dokumentet e punës të nivelit operacionel për kapjen e personave të kërkuar, janë të standartizuara bazuar në aktet e brendshme të Policisë së Shtetit dhe të Drejtorisë së Posaçme të Forcës Operacionale.

- ✓ Dy plane masash të hartuara nga subjekti në vitin 2019, 5 plane në vitin 2018 për ndjekjen dhe finalizimin e procedimeve penale të autorizuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, në vitet 2016, 2017, 2018, si dhe akte të tjera në vitet e mëparshme të shoqëruara me skica dhe skema të mënyrës dhe zonave të ndërhyrjes.

Nga njohja, studimi dhe analizimi i këtyre dokumenteve të punës të përgatitura nga subjekti në raport me funksionin dhe përshkrimet funksionale të punës, trupa vlerësuese konstaton se ato janë në përputhje me legjislacionin e Policisë së Shtetit, rregullores së brendshme të saj, procedurave standarte të punës për vëzhgimin e fshehtë të personave dhe mjediseve për kryerjen e operacioneve të veçanta policore, ligjit për forcat speciale dhe të ndërhyrjes së shpejtë dhe aktet urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për aktivizimin e reparteve të posaçme operacionale çdo plan operacionel në përfundim të tij, ka përcaktuar zhvillimin e analizë së planit të masave, duke evidentuar dhe mangësitë e konstatuara, rezultatet e arritura.

Në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit, trupa vlerësuese konstaton se në përgjithësi të gjitha operacionet e zhvilluara nga subjekti dhe nga sektori që ai ka drejtuar, janë shoqëruar rast pas rasti me dhënien e shpërblimeve me motivacion se subjekti është dalluar për organizim dhe realizim të operacioneve me rrezikshmëri të lartë për jetën në mjaft rrethe të vendit në kushte të vështira terreni e moti duke neutralizuar apo arrestuar mjaft elemente kriminal të shpallur në kërkim e të dënuar nga drejtësia shqiptare.

- ✓ *Konkretisht rezulton se subjekti është shpërblyer ndër vite (kjo e verifikuar nga aktet e dosjes personale dhe nga të dhënat bankare) me shuma të konsiderueshme në formë shpërblimesh çdo vit dhe mesatarisht nga një deri në dy paga mujore plus, ka vite të caktuara edhe deri në 6 paga shpërblim.*

Komisioni konsaton, se është aplikuar neni 67 i Ligjit 108/2014 për rezultate të larta në detyrë bazuar në kriteret e përcaktuara me udhëzim të Ministrisë deri në 6 paga mujore.

Subjekti gjithashtu është trajtuar në mënyrë periodike me dieta dhe trajtimin për ushqim e veshmbathje, kjo mbështetur në ligjin e policisë së shtetit, trajtuar në pjesën e vlerësimit në komponentin e pasurisë.

- ❖ ***Nga analiza e dokumenteve të përgatitura sa më sipër nga subjekti i vlerësimit Komisioni arrin në konkluzionin se:***
- ✓ Subjekti i vlerësimit ka njohuri të thelluara mbi legjislacionin që normon kuadrin ligjor të Policisë së Shtetit, si dhe akteve nënligjore në fuqi, që kanë të bëjnë me organizimin dhe funksionimin dhe drejtimin e Forcave të Posaçme Operacionale;
- ✓ Dokumentet e përgatitura nga subjekti i vlerësimit janë në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore që normojnë kuadrin ligjor për Policinë e Shtetit;
- ✓ Dokumentat e përgatitura nga subjekti i vlerësimit janë të qarta, të kuptueshme dhe të strukturuar logjikisht;
- ✓ Gjuha e përdorur nga subjekti i vlerësimit në përpilimin e dokumenteve zyrtare është në përputhje me normat dhe etikën profesionale të punonjësit të Policisë së Shtetit;

68. Është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit nga viti 2003 e vazhdim²⁷.

- ❖ ***Nga sa më sipër Komisioni Jashtëm i Vlerësimit arrin në konkluzionin se Subjekti Bujar Ahmeti:***
- ✓ Është i aftë profesionalisht për të realizuar detyrat e planifikuara dhe të ngarkuara;
- ✓ Është kërkues ndaj zbatimit të detyrave, si dhe ka zgjidhur në kohë detyrat dhe situatat që janë krijuar;
- ✓ I kryen detyrat në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore;

❖ ***Në përfundim të hetimit të kryer:***

Komisioni Jashtëm i Vlerësimit pas një hetimi të thelluar të kontrollit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit Bujar Zenel Ahmeti, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e vetëvlerësimit profesional, analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, arrin në konkluzionin se:

- ❖ ***Subjekti i vlerësimit Bujar Ahmeti***
- a) është i aftë, duke treguar cilësi të pranueshme në punë,*
- b) aftësi në zbatim të përshkrimeve të punës, të përcaktuara për atë funksion, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut,*
- c) është i frytshëm dhe i efektiv në masë të pranueshme*

²⁷ Certifikatë "Vital Installation Protection" Cairo 7-8/11/1998; Certifikatë MAPE 1999-2000 EU; Certifikatë "Menaximi dhe Udhëheqës për Drejtues të Lartë të Policisë së Shtetit" 23 Prill-04 Maj 2001; Certifikatë "Avokat" Nr. Diplomë 7998 datë 29/06/2003; Dëshmi Nr. 496 ku vërtetohet se Bujar Ahmeti është vlerësuar më 80 pikë në Gjuhën Serbo-Kroate-Universiteti i Gjuhëve të Huaja Tiranë; Certifikatë "Antiterrorizëm Assistance Program"-Luiziana 8 Prill 2005; Certifikatë "Crisis Response Team Training Cours" 8 Prill 2005 Luiziana; Certifikatë "Crisis Response Team Training" 8 Prill 2005 USA; Certifikatë "Bashkepunimi dhe bashkëpunimi institucionale midis strukturave të policisë, ushtrisë dhe pushtetit vendor, kompetencat ligjore dhe organizative në situata kritike dhe akte terroriste" 17-19 Nëntor 2009; Certifikatë "International Criminal Investigative Training Assistance Programme", 18-22 Nëntor 2012 Mali I Zi; Certifikatë Federata Bureau of Investigation "Survival Awareness In-Service", 05 Shtator 2013-Virginia; Certifikatë "Cours on Sports Security Techniques" 18-21/05/2015 Turqi; etj.

KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa vlerësuese e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha provat dhe shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, në përfundim të procesit të vlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Bujar Zenel Ahmti, në përputhje me nenin 60 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku tre kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollin e figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale;*

PËR KËTO ARSYE

Trupa Vlerësues Nr.4 e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, bazuar në pikën 7, 8, të nenit 56, të Ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar), pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në mbështetje të shkronjës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës “1” dhe “2” të nenit 60, të Ligjit të Vlerësimit nr. 12/2018 (i ndryshuar)

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit **Bujar Zenel Ahmeti, me funksion Drejtor i Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.**
2. Vendimi i aryetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brënda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit 12/2018 (të ndryshuar).
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë sot datë 14/02/2020

TRUPA E VLERËSIMIT

KRYESUES
Ledian RUSTA

RELATORE
Sonila KADAREJA

ANËTAR
Luljeta QOKU

